



Funded by
the European Union




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT

MBI MONITORIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2023



PËRFUNDUAR NË:
MARS 2025

RAPORT

PËR MONITORIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE INSPEKTORIATIT TË
LARTË TË DREJTËSISË

PËR PERIUDHËN JANAR– DHJETOR 2023

Finalizuar, në Mars 2025



Hartimi i këtij raporti realizohet në kuadër të nismës “Shoqëria Civile kundër korrupsionit nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Qëndrimet, opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk konsiderohen se reflektojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Përgatiti:

Znj. Blerina Bulica, Eksperte Ligjore e Jashtme, KShH

Rishikoi:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Znj. Eriselda Ndreca, Asistent Avokate dhe Koordinatorë Projektsh, KShH

Z. Njazi Jaho, Ekspert Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të,
Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752;
Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;
E-mail:office@ahc.org.al Web site: www.ahc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e përmbajtjes

SHKURTESA	5
HYRJE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
Për emërimet	9
Për komandimet	9
Për lëvizjet paralele.....	9
Për ngritjet në detyrë.....	10
Për skemën e delegimit	10
Për transferimet.....	10
Për procedurat disiplinore	11
PJESA E PARË: Metodologjia e monitorimit të KShH-së dhe prioritetet e KLGJ për vitin 2023	12
Metodologjia	12
2. Prioritetet në veprimtarinë e KLGJ	16
PJESA E DYTË - ANALIZA E VENDIMEVE SIPAS KATEGORIVE	18
1. Emërimet.....	18
Emërimet e magjistratëve të sapodiplomuar nga Shkolla e Magjistraturës	20
Emërimet e ndihmësve ligjorë	21
2. Komandimet e gjyqtarëve	21
3. Skema për delegimin e gjyqtarëve	22
4. Transferimet e gjyqtarëve	23
Transferimet e përkohshme me pëlqim.....	25
Përsëritja e transferimeve të përkohshme me pëlqim	25
Transferimet e përhershme me zgjedhje të gjyqtarëve	26
5. Lëvizjet paralele.....	28
6. Ngritjet në detyrë	29
7. Procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve	33
9. Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë.....	35
10. Rekomandime	38

SHKURTESA

KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
GjL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ILDKPKI Konfliktit të Interesave	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KËSHILLAT	Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Gjykatat e Posaçme	Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar/Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPAK	Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion
KZHK	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
CCJE	Këshilli Këshillimor i Gjyqtarëve Evropianë

Ligji nr.115/2016
i ndryshuar

Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

Ligji nr.96/2016

Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr.95/2016

Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar

Ligji nr.97/2016

Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr.98/2016
ndryshuar

Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit Gjyqësor në RSH”, i

Vendim Gj.K, nr. 34/2017

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.34/2017

Vendim GJ.K nr. 41/2017

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.41/2017

HYRJE

Ky raport monitorimi ofron një analizë të akteve administrative të nxjerra në vitin 2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me zhvillimin në karrierë të magistratëve, përfshirë dhe

procedurat disiplinore të filluara nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Në vazhden e përpjekjeve për të forcuar sundimin e ligjit dhe rritjen e pavarësisë së gjyqësorit, veprimtaria dhe vendimmarrja e institucioneve kyçe të qeverisjes së gjyqësorit luajnë një rol vendimtar në formësimin e karrierës së gjyqtarëve dhe mbrojtjes së statusit të tyre.

Analiza përmes këtij raporti merr për bazë përputhshmërinë e akteve administrative të KLGJ-së me standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare me synim promovimin e vlerave të meritokracisë së karrierës dhe rritjes profesionale të magistratëve. Qëllimi është të evidentohen standartet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në drejtim të mjeteve të përdorura nga ana e KLGJ-së në skemën e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, për të lehtësuar institucionet për hartimin e planeve konkrete si për rregullimin ligjor të procedurave ligjore, ashtu dhe për mënyrën e menaxhimit dhe organizimit sa më efikas të tyre. Kështu, nga analiza e detajuar e akteve të selektuara të KLGJ-së për skemën e zhvillimit të karrierës rezulton se vazhdon të jetë problematike garantimi i standarteve të parashikueshmërisë dhe qartësisë, në hartimin e akteve individuale dhe kolektive për emërimet, ngritjet në detyrë, dhe lëvizjet paralele. Ndërkohë, standartet e transparencës dhe efikasitetit janë evidentuar si problematike në vendimmarrjen për transferimet e përkohshme dhe ato me pëlqim të dedikuar, si dhe në vendimet për caktimin e gjyqtarëve në çështje të veçanta, për shkak të mungesës së një arsytimi të detajuar mbi mënyrën se si përmbushen kriteret ligjore nga kandidatët. Gjithashtu, është problematike sidomos në procedurat e emërimeve dhe ngritjes në detyrë, mungesa e menaxhimit efikas të faktorëve ngadalësues në kohëzgjatjen e procedurave, të cilat kërkojnë bashkëveprim të strukturave brënda KLGJ-së po ashtu dhe me institucione të tjera. Kjo problematikë paraqitet me një ndjeshmëri më të lartë për procedurat disiplinore të gjyqtarëve, për të cilat kërkohet një përpjekje e përbashkët nga ana e dy institucioneve përgjegjëse, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Në lidhje me këto procedura vërehet gjithashtu se vazhdon të jetë ende shqetësues arkivimi i procedimeve disiplinore të mbartura nga institucionet e mëparshme të drejtësisë që cënon parimin e sigurisë juridike sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Po ashtu mungon një sistem i integruar për të dhënat statistikore që të mundësojë konsolidimin e praktikës administrative për procedimet disiplinore, në kuadër të një transparence më të hapur për publikun, si dhe për grantimin e të drejtave proceduriale të magistratëve, subjekte të këtyre procedimeve.

KShH synon që me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve të këtij raporti të krijohet një sistem karriere i gjyqtarëve që spikat për profesionalizmin, integritetin, meritokracinë dhe eficiencën. Në këtë drejtim KShH mirëkupton ndikimin e shkaqeve objektive që vështirësojnë veprimtarinë e sistemit të drejtësisë, si vakancat e krijuara si rrjedhojë e procesit të vetingut, apo shkrirja e gjykatave sipas hartës së re gjyqësore. Kështu, pranohet se krijimi i vakancave të larta në stafin gjyqësor në vitin 2023, ku nga 408 gjyqtarë të miratuar në organikë, efektivisht ushtruan detyrën vetëm 247 gjyqtarë ka ndikuar në rritjen e ngarkesës në gjykata, si dhe në nevojën për plotësimin e trupave gjyqësore.

Po ashtu, impakt të drejtpërdrejtë ka pasur dhe shkrirja e gjykatave sipas hartës së re gjyqësore, përkatësisht nga riorganizimi që prej majit 2023 i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm nga 22 gjykata në 13, riorganizimi që prej shkurtit 2023 i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm nga 6 në vetëm 1 gjykatë apelit në Tiranë si dhe riorganizimi që prej korrikut 2023 i gjykatave administrative nga 6 në vetëm dy të tilla me kompetenca tokësore në Tiranë dhe Lushnjë.

Në këtë situatë, është i mirëkuptueshëm përdorimi i mjeteve të skemës së zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve nga ana e KLGJ-së, për zgjidhjen e një krizë të dukshme në gjykata, me vështirësi për të plotësuar numrin me gjyqtarë për trupat gjyqësorë. KShH dëshiron të inkurajojë institucionet të përdorin mjetet e kësaj skeme në mënyrë të përgjegjshme që ti shërbejë fillimisht zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, duke garantuar autonominë e gjyqtarit gjatë përdorimit të secilës prej tyre.

Analiza e problematikave dhe propozimi i rekomandimeve vjen në përgjigje të konstatimeve të parashtruara në raportet e fundit të Komisionit Evropian, mbi nevojën për përmirësim të mëtejshëm të rregullave dhe procedurave për emërimin dhe zhvillimin e karrierës së magjistratëve. Për çdo gjetje në këtë raport janë mbledhur të dhëna të disponueshme në faqet zyrtare të institucioneve nga aktet nënligjore normative, vendimet, rregulloret, aktet administrative kolektive dhe individuale, procesverbale me shkrim dhe audio, njoftimet e mbledhjeve plenare të Këshillave të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Së fundmi, KShH si një organizatë monitoruese dhe e pavarur shpreson që problematikën dhe rekomandimet konstruktive të këtij raporti, të cilat nuk kanë karakter detyrues, të analizohen dhe shqyrtohen me kujdesin e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse, duke kontribuar në nxitjen dhe promovimin e llogaridhënies dhe pavarësisë fillimisht të vetë organeve të qeverisjes së sistemit gjyqësor e po kështu edhe pushtetit gjyqësor.

Në tryezën e dt.25 Nëntor 2025, KShH promovoi debatin konstruktiv dhe impaktues me aktorë të sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë civile, për hapat e mëtejshëm drejt rezultateve të kërkuara nga publiku sa i takon efijencës së reformës në drejtësi, duke u ndalur ndër të tjerash në diskutimin e këtij draft raporti. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit konstruktiv, institucioneve të monitoruara në këtë raport j'u dha mundësia të japin komentet dhe sugjerimet e tyre, të cilat, në respektim të parimit të pavarësisë dhe transparencës së KShH-së janë bërë pjesë e këtij raporti kur janë vlerësuar si të drejta.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo përmbledhje ekzekutive reflekton vetëm disa nga konkluzionet kryesore të monitorimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës 1 vjeçare, Janar – Dhjetor 2023.

Për vitin 2023 në periudhën objekt monitorimi, KLGJ ka qënë e ndikuar në administrimin e sistemit të karrierës së gjyqtarëve nga disa faktorë, si: zbatimi i hartës së re gjyqësore për shpërndarjen e gjyqtarëve nga gjykatat e suprimuara dhe plotësimi i vakancave të krijuara në sistem për shkak të procesit të vetingut. Vlen të theksohet se vetë organet e qeverisjes së gjyqësorit, sikurse është ILD përballen me mungesa në organikën që funksionon me mungesë inspektorësh.

Për përballimin e mbingarkesës së krijuar, KLGJ ka përdorur skemën e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, duke përfshirë lëvizjet paralele, transferimet (*sidomos në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm*), delegimet, dhe caktimet e gjyqtarëve në çështje të veçanta. Krahas kësaj skeme, KLGJ ka gjetur dhe mënyra *ad hoc* për menaxhimin e vakancave si: sigurimi i kandidatëve për gjyqtarë¹ përmes rritjes së kuotave për magjistratët kandidatë, si dhe menaxhimi efikas i nëpunësve gjyqësorë civilë.

Për emërimet

Ecuria e procesit të emërimeve rezulton të jetë e avashtë për periudha që zgjasin afro 1 vit e gjysëm. Po ashtu kuadri ligjor që gjen zbatim për emërimin e magjistratëve nga kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës krijon barrë administrative për institucionet e drejtësisë. Kjo pasi verifikimi i pastërtisë dhe figurës dhe vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve rezulton të bëhet dy herë brënda një harku kohor prej 3 vitesh: një herë për pranimin në shkollën e magjistraturës dhe një herë për emërimin pas diplomimit. Rrjedhimisht, lind nevoja për krijimin e mekanizmave koordinues për menaxhimin sa më efikas të procedurave të emërimit dhe rishikimi i kuadrit ligjor për procedurat për verifikimin e pastërtisë, figurës dhe vlerësimit etik/profesional për kandidatët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës (ShM).

Për komandimet

Skema e komandimit duket se ka ndihmuar kryesisht Gjykatën e Lartë (GjL) dhe Gjykatën Kushtetuese (GjK) për plotësimin në radhët e këshilltarëve ligjorë. Përdorimi i kësaj skeme është pozitiv në mënyrë të veçantë për GjL, nisur dhe nga fakti që kjo gjykatë përballlet me numrin më të lartë të çështjeve të mbartura. Megjithatë, KShH ri thekson se komandimi i magjistratëve për plotësimin e vakancave të përkohshme për pozicionet jogjyqtar në institucionet e drejtësisë nuk justifikohet në kushtet kur sistemi i gjykatave ka mungesa të theksuara në profilin e gjyqtarëve.

Për lëvizjet paralele

Sipas konfirmimit të marrë nga institucioni i KLGJ-së, figuron se në shumë raste lëvizjet paralele kryesisht janë zgjatur në kohë, për shkak të tërheqjeve të kandidatëve nga procedurat. Në këtë drejtim, KShH inkurajon zbatimin sa më rigoroz të procedurave të verifikimit të kandidatëve për një sinkronizim sa më të mirë të procedurave administrative, në respektim të nenit 53 të vendimit të KLGJ-së, nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”,

¹Sidomos për plotësimin e vendeve në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatën e posaçme të shkallës së parë

duke synuar minimizimin sa më shumë të shtyrjeve në kohë që krijojnë tërheqjet e kandidatëve nga gara për një pozicion të caktuar.

Për ngritjet në detyrë

Procedurat për ngritjen në detyrë në vitin 2023 kanë shërbyer për emërimin e gjyqtarëve të GjL të Gjykatës së Apelit së Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe Gjykatës së Apelit Administrativ. Nga analiza e akteve të studiuara ka rezultuar se kohëzgjatja e procedurave ka variuar nga 6 muaj deri në 2 vjet e gjysëm. Shkaqet lidhen me tejzgjatjen e periudhës nga hapja e pozicioneve deri në datën e fillimit të procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore, e cila në disa prej rasteve ka variuar nga 9 muaj deri dy vjet. Faktorët që kanë ndikuar në tejzgjatje të tilla lidhen kryesisht me ndërlidhjen e procedurave për: (1) verifikimin e pasurisë dhe figurës së gjyqtarit, (2) vlerësimin etik dhe profesional, (3) ezaurimin e mjeteve të ankimit nga ana e kandidatëve në respektim të procesit të rregullt ligjor, (4) rivlerësimin kalimtar kur kandidatë janë subjekte të procesit të vetingut. Pavarësisht këtyre faktorëve, në tërësi, kjo kohëzgjatje nuk vlerësohet e arsyeshme dhe efiçiente.

Për skemën e delegimit

Skema e delegimit ka krijuar fleksibilitet për angazhimin e gjyqtarëve për pozicione të përkohshme duke i shërbyer plotësimit të nevojave në gjykatat që janë përballur me vakanca, sidomos në rastet e pozicioneve vakante në Gjykatën e Posaçme, në të cilën mund të zbatohet vetëm skema e delegimit për të plotësuar vendet përkohësisht të lira, duke qenë se nuk lejohet transferimi i gjyqtarëve.²

Për transferimet

KLJGJ ka marrë disa vendime për transferimin e përkohshëm, për transferim me përsëritje dhe për transferimin me zgjedhje të gjyqtarëve, duke synuar balancimin e ngarkesës së gjyqtarëve, po ashtu dhe për caktimin e gjyqtarëve pas suprimimit të gjykatave me zbatimin e hartës së re gjyqësore. Vendimet për transferimet pranë gjykatave që kanë mungesë të gjyqtarëve nuk pasqyrojnë mbi bazën e treguesve konkretë të ngarkesës së gjykatës, vakancave, etj, nevojën për mbështetje për të plotësuar trupat gjyqësore për përballimin e ngarkesës për 1 vit. Vendimet për transferimin e përkohshëm nuk pasqyrojnë se si përmbushen kriteret ligjore, si p.sh: sa ka qënë numri i kërkesave për secilin pozicion vakant në secilën prej gjykatave, si janë përmbushur kriteret nga secili prej tyre, cili është efekti që krijon transferimi tek gjykatat e gjyqtarëve që transferohen, cila do jetë dobia e gjykatës pritëse.

Përsëritja e transferimeve të përkohshme *me pëlqim* për të ndihmuar gjykatat për plotësimin e trupave gjyqësore, sugjerohet të vazhdojë të përdoret në mënyrë sa më të moderuar, e balancuar dhe me mënyra të tjera të mobilitetit të gjyqtarëve, për shkak se transferimet e përsëritura ndikojnë në cënimin e autonomisë gjyqësore dhe besueshmërisë së figurës së gjyqtarit. Vendimet për procedurat për transferimet *me pëlqim të dedikuar*, rezultojnë se janë marrë brenda të njëjtës ditë

²ipas pikës 8 të nenit 42 të Ligjit për Statusin

me shpalljen e procedurës së transferimit, çfarë krijon mangësira në aspektin cilësor, për shkak se i jep procesit një karakter ngushtësisht formal dhe të paracaktuar në kuptim të rezultatit të tij. Së fundi, në vendimet për procedurat për transferimet *me pëlqim të dedikuar* është e paqartë se mbi ç’bazë kriteresh është udhëhequr KLGJ në përzgjedhjen e gjykatave të rretheve gjyqësore që j’u propozuan gjyqtarëve që kanë një pozicion të përhershëm në gjykatën që ju nënshtroa shkrirjes, për shkak të zbatimit të hartës së re gjyqësore.

Për procedurat disiplinore

KShH vëren se për procedimet disiplinore të mbartura nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (*Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë*), ILD ka ndjekur si praktikë arkivimin e kërkesave ose mbylljen e procedimit, duke argumentuar se shkaqet e shkeljeve janë parashkruar sipas ligjit të mëparshëm. KShH vlerëson se kjo praktikë nuk është e drejtë pasi në respektim të parimit të vazhdimësisë institucionale, tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve dhe jo për faj të ankuesve.³ Sipas shpjegimeve të ILD-së rezulton se menjëherë pas fillimit të funksionimit të tij, institucioni ka mbartur rreth 2104 ankesa nga KLGJ dhe KLP, të cilat janë vlerësuar duke ndjekur një rend kronologjik sipas datës së tyre të regjistrimit dhe statusit të tyre procedural. Megjithatë, sipas konstatimeve të ILD-së rezulton se ankesat e transferuara për hetimin disiplinor të magjistratëve, kanë qënë të gjitha të papërfunduara, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 160,168,170 që kërkojnë për të gjitha organet e hetimit disiplinor të përfundonin praktikën e filluara brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Për më tepër, institucioni i ILD-së nuk është asistuar nga inspektorë të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), të ngarkuar me hetimet disiplinore, të cilët sipas nenit 168, pika 3 e Ligjit Nr.96/2016 duhej të ishin komanduar pranë ILD-së. Ky fakt ka penguar ecurinë normale për trajtimin e ankesave të trashëguara nga ish KLD dhe Prokurori i Përgjithshëm, çfarë do të garantonte dhe sigurimin e vijueshmërisë institucionale. Po ashtu, ILD ka raportuar se nga praktikën e pambyllura të dorëzuara nga KLGJ për periudhën 2020-2023, janë ndërmarrë 26 hetime, prej të cilave janë propozuar 11 kërkesa për procedim disiplinor pranë KLGJ-së. Për këto raste nuk ka pasur ankime ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimit të ILD-së.

Është e nevojshme të zhvillohet një koordinim sa më efikas ndërinstitutional mes ILD-së dhe KLGJ-së, për menaxhimin e zvarritjeve të seancave plenare për procedimin disiplinor, për shkak të mungesës së përsëritur të gjyqtarit që është subjekt i këtij procedimi. Ky koordinim duhet të ketë në fokus edhe integrimin e të dhënave mbi procedimet disiplinore.⁴ Për këtë qëllim, KShH vlerëson se KLGJ duhet të publikojë procesverbalet dhe aktet administrative për procedimet disiplinore në një rubrikë të dedikuar vetëm për procedimet disiplinore, me qëllim që përdoruesit e faqes të jenë sa më të orientuar në gjetjen e informacionit. Në mënyrë që të sigurohet menaxhim i

³ Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

⁴ Të dhëna duke respektuar kriteret për masat disiplinore sipas kategorive si, vërejtjet, pezullimet, shkarkimet (nenet 100-116 të ligjit për statusin)

integruar i të dhënave për procedurat disiplinore të gjyqtarëve, ILD inkurajohet të krijojë në faqen zyrtare regjistrin me të dhëna mbi trajtimin e ankesave dhe hetimeve administrative disiplinore.

Së fundi, institucioni i ILD-së edhe pse përballët me administrimin e 2340 ankesave përfshirë dhe ato të mbartura nga viti i kaluar, volumi i punës që mbulon ky institucion për 18 hetime disiplinore nuk përmbush në vlerësimin e KShH-së standartet e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së gjyqësorit. Këtë konkluzion e bazojmë edhe në faktin krahasimor të volumit mesatar të ngarkesës së gjyqtarëve përgjatë një viti që sipas raportit të KLGJ-së për vitin 2023 arrin 841 çështje për gjyqtar.⁵

PJESA E PARË: Metodologjia e monitorimit të KShH-së dhe prioritetet e KLGJ për vitin 2023

Metodologjia

Objekt i monitorimit të këtij raporti janë aktet normative dhe vendimarrjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) për ngritjen në karrierë dhe disiplinën e gjyqtarëve, për periudhën Janar – Dhjetor 2023. Qëllimi i monitorimit të këtyre akteve është vlerësimi i mënyrës së zbatimit të Kushtetutës, ligjeve⁶ dhe akteve nenligjore për emërimet, ngritjen në detyrë, transferimet, lëvizjet paralele, komandimet, caktimin e gjyqtarëve në çështje të tjera si dhe procedimet me natyrë disiplinore.

Sipas të dhënave në vitin 2023 të pasqyruaranë tabelën më poshtë⁷ figuron se KLGJ ka miratuar në lidhje me karrierën e gjyqtarëve 743 vendimeve (24% më shumë se 1 vit më parë) nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregullatore të brendshme dhe 1 udhëzim, si dhe janë zhvilluar 80 mbledhje plenare.⁸ Nga 503 akte të evidentuara përmes faqes zyrtare të KLGJ-së, përgjithësisht rezulton se ka një trend për miratimin e: 25% të akteve për emërimet; 21 % të akteve për lëvizjet paralele në detyrë; 19% të akteve për ngritjet në detyrë; 13% të akteve për transferimet e gjyqtarëve; 6% akteve për caktimet në çështje të tjera; 5% akteve për komandimet; 5% akteve për procedurat disiplinore; dhe 3% akteve për delegimet.⁹

⁵Shih raporti vjetor i KLGJ-së, faqe 93.

⁶Ndryshimet Kushtetuese të miratuara me ligjin nr.76/2016; Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit Gjyqësor në RSH”; Vendimarrje të Gjykatës Kushtetuese si psh Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.34/2017 dhe vendimi nr.41/2017 i po kësaj gjykate që shfuqizon disa dispozita të ligjit nr.96/2016 dhe 115/2016.

⁷Të siguruara nga faqja zyrtare e KLGJ

⁸Raporti vjetor i KLGJ, viti 2023.


⁹Sqarohet se evidentimi i të dhënave statistikore nuk është objekt thelbësor i analizës së këtij raporti, për rrjedhojë evidentimi i këtij trendi ka pasur qëllim thjesht ilustrues.

Kategoritë e akteve që do studjohen	Akte kolektive	Akte individuale	Përqindje e akteve në raport me totalin	Selektimi i akteve që do analizohen
Emërimet (129)	3	126	25%	13
Levizjet paralele (106)	29	77	21%	10
Ngritjet në detyrë (96)	23	73	19 %	9
Transferimet (68)	44	24	13%	7
Caktimet në çështje të tjera (32)	32	0	6 %	3
Komandimet (28)	21	7	5 %	3
Procedurat disiplinore (28)	6	22	5 %	3
Delegimet (16)	4	12	3 %	1
Total (503)	162	341	100%	50

Trendi i pasqyruar në tabelën e mësipërme nuk ka qëllim të evidentojë të dhëna të sakta statistikore, por synon të ilustrojë në vija të përgjithshme se cilat mjete kanë qënë më efikase për menaxhimin e situatës në gjykatat, sidomos ato më të mëdha, për shkak të nevojës për plotësimin e trupave gjyqësore dhe krijimit të vakancave nga rradhët e gjyqtarëve. Në lidhje me këtë, KLGJ ka sqaruar se në çdo vendimarrje të saj për aplikimin e skemës së zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, i është përgjigjur nevojës emergjente të gjykatave dhe në përpjekje maksimale për të mos cënuar funksionalitetin e gjykatave, të cilat tashmë kanë pasur vakanca si rrjedhojë e zbatimit të hartës së re gjyqësore dhe Ligjit nr. 84/2016 “Per rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSh”.

KShH vlerëson se referuar të dhënave për numrin e ulët të procedimeve disiplinore për gjyqtarët (vetëm 5 të tilla) rezulton se nuk është ruajtur një qasje proporcionale sa i takon përgjegjshmërisë që fillohet nëpërmjet procedimeve disiplinore, të cilat varen nga kërkesat e bëra prej ILD-së dhe konkludohen me vendimarrje nga Këshilli. Kjo përgjegjësi e përbashkët ndërinstitucionale duhet parë në respektim të parimit të qeverisjes së mirë të sistemit të drejtësisë, sipas nenit 2 te ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që parashikon se sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efijencës.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023, frekuenca e vendimeve administrative në total është 42 vendime në muaj, afërsisht 2 vendime në ditë (nëse marrim në konsideratë 22 ditë pune në muaj). Akte individuale janë mesatarisht 28 vendime në muaj, afërsisht pak më shumë se 1 vendim në ditë, ndërsa ka pasur afërsisht 13 akte kolektive në muaj.



Në këtë raport monitorues i janë nënshtruar analizës cilësore 50 akte në total, që përbëjnë 7% të akteve kolektive dhe individuale që janë miratuar nga KLGJ për vitin 2023. Objekt i analizës është mënyra e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për procedurat e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, më konkretisht, e shtjelluar në vijimësi:

Për verifikimin e procedurave për lëvizjen paralele janë përzgjedhur 10 akte, për të evidentuar nëse janë respektuar kërkesat për shpalljen e pozicionit, afatin e kandidimit, procedurën e kandidimit, respektimin e kriterëve për vitet e eksperiencës në punë (të paktën 1 vit gjatë pesë viteve të fundit), kërkesat në rastet e kandidimit për disa pozicione etj. Në lidhje me këtë procedurë merr rëndësi dhe mënyra e renditjes së kandidatëve,¹⁰ sidomos kur nuk ka mjaftueshëm aplikime.

¹⁰Vendimi nr.320, datë 17.09.2020, parashikon kriteret dhe procedurat e renditjes së gjyqtarëve për lëvizjen paralele sipas dy vlerësimeve të mëparshme, përvojën profesionale specifike, vjetërsinë si magjistrat.

Për verifikimine procedurave për ngritjen në detyrë janë përzgjedhur 8 akte, për të shqyrtuar se si janë zbatuar kriteret dhe procedurat ligjore,¹¹si:

Respektimi i afatit të kandidimit,

Publikimi i shpalljes së pozicioneve të lira nga Këshilli,

Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë,

Caktimi i relatorit të procedurës së verifikimit,

Fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit,

Kualifikimi dhe renditja e kandidatëve,

Verifikimi i pasurisë dhe figurës nga relatori dhe Komisioni për Zhvillimin e Karrierës (KZHK),

Vlerësimi etik/profesional i kandidatëve me qëllim që të përcaktohet grada e vlerësimit për gjyqtarët për periudhën 2013-2016,¹²

Vlerësimi etik dhe profesional i përshpejtuar i kandidatëve nga KZHK,

Kualifikimi dhe miratimi i renditjes së kandidatëve,

Vendimi për ngritjen në detyrë të kandidatit.

Për procedurat e emërimit janë përzgjedhur 11 akte administrative për të analizuar si është respektuar standardi i pavarësisë së gjyqtarit dhe si gjejnë zbatim parimet dhe procedurat për vlerësimin individual, nëpërmjet verifikimit të kriterëve që lidhen me kualifikimin e tyre profesional, etikën, figurën dhe pasurinë. Në fokus të veçantë të analizës është respektimi i drejtësisë procedurale, e cila është thelbësore në të gjithë elementët e vlerësimeve individuale, ku gjyqtarët kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të kundërshtojnë vlerësimet.

Për procedurat e komandimit të gjyqtarëve janë përzgjedhur 2 akte administrative për të verifikuar aspekte të tilla si: nëse për komandimin nuk kishte mandat të kufizuar të magjistratit, nëse ka kaluar afati më shumë se 10-vjet për periudhën e komandimit, nëse kishte parregullsi në matjen e vjetërsisë në profesion për efekt të periudhës së komandimit për magjistratët në shkallë të parë dhe të dytë.

Për skemën e delegimit të gjyqtarëve është verifikuar vetëm një akt administrativ për të analizuar anën formale të kërkesave që duhen për skemën e delegimit si: nëse magjistrati ka

¹¹Vendimi i KLGJ nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”

¹²Referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

nënshkruar një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë dhe nëse është tejkaluar periudha jo më shumë se 5 vjet për shërbimin në skemën e delegimit.

Për transferimin e gjyqtarëve janë përzgjedhur 7 akte administrative për të analizuar se si zbatohen kriteret specifike për transferimin në një pozicion të përkohshëm të lirë (për të paktën 3 muaj) ose të përhershëm, të cilat ndryshojnë në varësi të gjykatës ku bëhet transferimi, nivelit të kësaj gjykate në raport me gjykatën ku transferohet magjistrati, rastet e papajtueshmërisë ambientale, etj. Për shkak të specifikave, transferimet për lëvizjen paralele dhe ngritjet në detyrë janë trajtuar veçmas për secilën kategori në këtë raport.

Për caktimin e gjyqtarëve në çështje të tjera janë përzgjedhur 8 akte administrative për të analizuar nëse janë respektuar kërkesat procedurale si: hedhja e shortit, zbatimi i kriterëve respektive, sipas nevojave aktuale të gjykatave, garantimi i pavarësisë së gjyqtarit, llogaridhënies dhe nevojat për progresin e punës në gjykata.¹³

Për procedurat disiplinore të gjyqtarëve janë përzgjedhur 3 akte administrative për të vlerësuar në veçanti nëse ILD dhe KLGJ marrin parasysh mbrojtjen e integritetit dhe figurës së gjyqtarit, nëse respektohen procedurat ligjore dhe nëse garantohet përgjegjshmëria e gjyqësorit. Rëndësi në këtë analizë merr dhe si garantohet informimi i publikut në lidhje me shkeljet disiplinore në funksion të administrimit të drejtësisë. Në veçanti është analizuar:

A garantohet balancimi i parimit të drejtësisë së hapur me parimin e konfidencialitetit, dhe të drejtën për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale?

A është numri i ankesave për procedime disiplinore që ILD paraqet në proporcion me punën e tij, si i vetmi organ përgjegjës për fillimin e procedimit disiplinor?

A respektohet afati i arsyeshëm në procedimet disiplinore?

A ka një balancë të drejtë midis pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor nga KLGJ?

2. Prioritetet në veprimtarinë e KLGJ

Disa nga prioritetet kyç që KLGJ ka vendosur në dokumentat e tij strategjike si: raportet vjetore të punës për vitin 2023, plani strategjik i vitit 2022-2024, si dhe raportet e komisioneve të përhershme për vitin 2023, të cilat janë në fokus të monitorimit të KShH-së, janë si vijon:

Promovimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve

Edhe pse plotësimi i vakancave nëpër gjykata ka qënë objektiv kryesor për KLGJ-në nëpërmjet promovimit të gjyqtarëve përmes lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo komandimeve, rezulton se procedimet disiplinore nuk kanë pasur të njëjtin trend. Kështu konstatohet se ILD dhe KLGJ

¹³Opinion i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, nr. 17 (2014) "Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë dhe Respektin për Pavarësinë e Gjyqësorit"; Opinion nr. 4 i CCJE-së, mbi trajnimin e duhur fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve në nivel kombëtar dhe evropian.

nuk kanë pasur mjaftueshëm produktivitet për garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve, pasi numri total i ankesave për procedurat disiplinore që administrohen nga ILD është ndjeshëm jo proporcional në raport me procedimet disiplinore që konkludohen me kërkesë për inicim tek KLGJ.

Plotësimi i trupave gjyqësore në gjykata

Gjatë vitit 2023, KLGJ ka synuar plotësimin e trupave gjyqësore në gjykatat me ngarkesë të lartë çështjesh, si pasojë e vakancave të krijuara për shkak të ri-vlerësimit të gjyqtarëve nga procesi i vetingut, duke synuar ose mundësuar:

Rritjen e kuotave dhe rekrutimin e magistratëve kandidatë të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës (40 në vitin akademik 2022-2023),

Menaxhimin efikas të nëpunësve gjyqësorë civilë,

Ngritjes në detyrë për plotësimin e 4 vendeve të mbetura vakante në Gjykatën e Lartë (duke mundësuar plotësimin e saj me 19 anëtarë),

Kryerjen e transferimeve¹⁴dhe delegimeve, lëvizjes paralele për 11 gjyqtarë, si dhe nëpërmjet caktimit të 208 gjyqtarëve në çështje të tjera.¹⁵

Edhe pse janë përdorur mjetet e skemës së zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, është objektivisht i justifikuar fakti se nuk janë adresuar vakancat në sistemin tonë gjyqësor në vitin 2023, i cili ka funksionuar me 247 gjyqtarë efektivisht në detyrë, nga 408 gjyqtarë që përcakton struktura organizative (organika në fakt rezulton 329 gjyqtarë). Po ashtu rezulton tejet problematike numri i vakancave të gjyqtarëve në: Gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm të cilat kanë pasur mungesë 44% të gjyqtarëve; në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ka pasur mungesën më të gjyqtarëve në masën 57%; në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën 31%; dhe në Gjykatën e posaçme të shkallës së parë, e cila ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën 56 %. Për këtë arsye, KShH ripërsërit qëndrimin e mëhershëm se zgjidhja e problemit sistematik të vakancave në sistemin e gjykatave kërkon strategji efektive për plotësimin e duhur dhe cilësor të tyre, si dhe zgjidhje që kërkon objektiva dhe masa të qarta e arritshme, në të ardhmen.

Zbatimi i reformës për nëpunësin civil gjyqësor

Një menaxhim sa më efikas i ndarjes së roleve të nëpunësve civil gjyqësor ka qënë me rëndësi në sistemin gjyqësor, në një kohë kur ka pasur nevojë për staf gjyqësor. Në këtë drejtim përmes miratimit të rregullave standarte për rolet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata dhe rritjes së kuotave për ndihmës ligjorë në Shkollën e Magistraturës, ka qënë prioritet gjatë vitit akademik 2023-2024 plotësimi i numrit të ndihmësve ligjorë në gjykatat e

¹⁴ Janë transferuar 33 gjyqtarë në gjykata sipas raportit të KZHK, 2023.

¹⁵ Shih Raporti vjetor i KZHK për vitin 2023.

apeleve, emërimi i një këshilltari ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, verifikimi dhe pranimi në shërbimin civil gjyqësor të 4 nëpunësve civilë gjyqësorë dhe përfundimi i procedurave të verifikimit të 7 kancelarëve në detyrë. KShH vlerëson se njësoj si për gjyqtarët ashtu dhe për nëpunësit gjyqësorë civil është e rëndësishme të garantohet një sistem promovimi në karrierë, duke vënë theksin se rekrutimi dhe promovimi meritokratik i tyre kërkon procedura që garantojnë kërkesat për një kohëgjatje të arsyeshme.

Transparenca në faqen zyrtare

KShH vlerëson se KLGJ ka disa arritje në drejtim të transparencës për vitin 2023. Gjithsesi në këtë drejtim mund të merren një sërë masash të tjera në të ardhmen që synojnë përmirësimin e aksesimit të akteve që publikohen në faqen zyrtare të KLGJ-së. Në veçanti, aktet për procedurat disiplinore aksesohen me vështirësi përmes publikimit të mbledhjeve plenare, të cilat nuk ndjekin një renditje sipas objektit të axhendës por publikohen sipas datave pa pasur një identifikim konkret të tyre. Gjithashtu, KShH risjell në vëmendje gjetjet e raporteve të tij të mëhershme se aktet e KLGJ-së nuk shoqërohen mjaftueshëm me arsyetimin e tyre përkatës që të lehtësojnë publikun për të kuptuar meritën e procesit administrativ të promovimit apo ngritjes në detyrë¹⁶ dhe të garantojnë transparencën e procesit.

PJESA E DYTË - ANALIZA E VENDIMEVE SIPAS KATEGORIVE

1. Emërimet

Procedurat për emërimin e gjyqtarëve duhet të jenë të qëndrueshme për të evituar subjektivizmin si dhe duhet të përmbushin kërkesat procedurale për promovimin e tyre me transparencë dhe integritet të lartë. Gjithashtu, procedurat e emërimit kërkojnë garantimin e meritocracisë, transparencës, pavarësisë së gjyqësorit, eliminimin e konflikteve të interesit, respektimin e diversitetit, vlerësimin e rregullt periodik etik dhe profesional, si dhe garantimin e funksionit të gjyqtarit.

Gjetje: Për emërimin e gjyqtarëve në detyrë në periudhën Janar - Dhjetor 2023, nga ana e KLGJ-së janë miratuar 3 akte administrative kolektive dhe 126 akte administrative individuale.

Aktet individuale janë kryesisht për:

kualifikimin për emërim të kandidatëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës,

kualifikimin për emërim në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit,

propozimin për emërim të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë,

¹⁶Sipas nenit 89, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”.

kualifikimin e kandidatëve për ndihmësligjore,

emërimin e gjyqtarëve të diplomuar nga ShM.

Aktet kolektive janë kryesisht për:

shpallje procedure për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e gjyqtarëve,

shpalljen e vendeve vakante për ndihmësit ligjor në gjykatat e apeleve,

shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarë të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023.¹⁷

Nisur nga nevoja urgjente për plotësimin e 4 vakancave për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë të hapura që nga viti 2022, në periudhën objekt vlerësimi merr rëndësi garantimi i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave, për emërimin e gjyqtarëve në këtë gjykatë. Sipas akteve të analizuara rezulton se në Gjykatën e Lartë procedurat për rekrutimin e gjyqtarëve janë të rregullta në drejtim të njoftimit të kandidatëve për afatet e procedurave, për të drejtën e tyre për të bërë ankim brenda 5 ditëve ndaj vendimit përfundimtar etj. Më tej, konstatohet si problematike tejzgjatja e procesit nga data kur është shpallur pozicioni i lirë dhe deri në datën e vendimit të propozimit, e cila ka variuar 1 vit e 5 muaj,¹⁸ apo 1 vit e 8 muaj dhe deri 1 vit e 10 muaj.¹⁹ Sipas sqarimeve të KLGJ-së, rezulton se zgjatja në kohë e këtyre procedurave është rrjedhojë e ankimit të ushtruar nga kandidatët dhe pritjes së vendimit të formës së prerë nga gjykatat, e cila është një periudhë relativisht e gjatë deri në arsyetimin e vendimit²⁰. Në lidhje me emërimet në GJL, KShH vlerëson se tejzgjatja e procesit mund të menaxhohet më mirë, duke marrë në konsideratë që:

Numri i kandidatëve për gjyqtar është relativisht i ulët (vetëm 6 aplikantë),

Nevoja urgjente për plotësimin e vakancave në këtë gjykatë ka qenë e lartë,

Kërkesa për sigurimin e standarteve të efikasitetit dhe cilësisë së gjyqësorit,

Procedurat për këtë pozicion janë ato që zbatohen për ngritjen në detyrë që zgjasin mesatarisht rreth 6 muaj,

Kandidatët vijnë nga rradhët e gjyqtarëve të gjykatave më të ulëta,

¹⁷ Vendim Nr.582, datë 18.10.2023

¹⁸ Vendimi i Këshillit nr. 270/2023.

¹⁹ Sipas vendimeve për propozimin e kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë (respektivisht me Vendim nr.474, datë 13.09.2023 dhe me Vendim nr. 458, datë 25.07.2023 të Këshillit)

²⁰ Për shëmbull, në rastin A. Nasufi, me datë 11.07.2024 është shqyrtuar rekursi kundër vendimit datë 27.03.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit nga Gjykata e Lartë dhe kjo e fundit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka rrëzuar kërkesën, me të cilin është kërkuar shfuqizimin e vendimit të KLGJ nr. 537, 14.12.2022.

Volumi i verifikimeve nuk është kompleks pasi nuk përfshihen procedura si p.sh Intervistat.

Sipas sqarimeve të KLGj-së, në lidhje me sa më sipër, një faktor që ndikon në kompleksitetin e procedurave të emërimit për anëtarët e Gjykatës së Lartë, është se për këto raste janë përdorur procedurat e ngritjes në detyrë, të cilat në vetvete ndërlidhin procese administrative për vlerësimin etik e profesional të kandidatëve. Më konkretisht, Këshilli për këtë qëllim vë në lëvizje dy komisione të tij: (1) KZHK-në që vendos për renditjen e kandidateve që përmbushin kërkesat ligjore për numrin e vlerësimeve, (2) Komisioni i Vlerësimit Etik e Profesional që vijon me procedurën e vlerësimit etik profesional.²¹ Kjo ndërlidhje procedurash vështirësohet për shëmbull kur siguri i dy vlerësimeve për kandidatët mbetet pezull për shkak të verifikimit të ankesave të qytetarëve ndaj magjistratit, pasi janë objekt verifikimi dhe shqyrtimi nga ILD. Për raste të tilla, vetëm pas vendimarrjes së ILD-së, mund të vijohet më tej me procedurat e vlerësimit etiko-profesional të kandidatëve

KShH i mirëkupton vështirësitë që pasojnë për shkak të ndërlidhjes së procedurave administrative, por në të njëjtën kohë thekson se sa e rëndësishme është të sigurohen mjete për menaxhimin sa më të mirë të verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve për kualifikim, në kohë të arsyeshme dhe më dinamike të procedurave të promovimit. Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme në gjykatat që kanë numër vakancash të larta të gjyqtarëve dhe njëkohësisht numër të lartë të çështjeve të fondit “backlog”.

Emërimet e magjistratëve të sapodiplomuar nga Shkolla e Magjistraturës

Hapja e pozicioneve vakante për gjyqtarët e diplomuar në përfundim të programit tre-vjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitet 2020-2023 dhe kualifikimi i tyre për emërimin²² me të drejtë zgjedhje në një nga gjykatat me pozicione vakante²³ ka pasur parregullsi në drejtim të respektimit të afatit ligjor një muaj të përcaktuar në ligj.²⁴ Më konkretisht, për 40 kandidatët e kualifikuar është konstatuar si problematike vonesa dy muaj e gjysëm për emërimin dhe caktimin e tyre në detyrë, jashtë këtij afati ligjor. KLGJ ka sqaruar se vonesa ka ardhur për shkak të hapjeve të pozicioneve të lira për magjistratët, të cilat në mbështetje të ligjit fillimisht plotësohen përmes lëvizjes paralele (të cilat shpallen rregullisht sipas ligjit çdo 3 muaj), e më tej vazhdohet me shpalljen e vendeve vakante në gjykata. Sipas konstatimeve, Këshilli është angazhuar që procedura e lëvizjes paralele të eci paralelisht me ecurinë e vlerësimeve etike e profesionale, pikërisht për të shmangur tejzgjatjen e procedurave. Vetëm në 1 (një) rast është realizuar caktimi i një magjistrati të sapodiplomuar në pozicion 9 (muaj) pas diplomimit të tij (rasti A.Keraj), kjo për shkak të nisjes së procedimit disiplinor ndaj tij. Në çdo rast, KShH thekson se në

²¹ Ky vlerësim është i nevojshëm për procedurën e renditjes së kandidateve (Neni 48 i Ligjit për Statusin, vendimi nr. 320 datë 17.09.2020 i, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” KREU VI, B1, pika 79)

²² Sipas Vendimit KLGJ Nr.582, Datë 18.10.2023

²³ Si në: Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë dhe Berat.

²⁴ Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

të ardhmen kërkohej një vëmendje më e lartë nga ana e KLGJ-së për përmbushjen në kohë të këtyre procedurave.²⁵

Një fakt tjetër që meriton vëmendje për kategorinë prej 40 gjyqtarësh të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës është verifikimi i tyre dy herë për kriterin e pasurisë dhe figurës në një hark kohor prej tre vitesh. Më konkretisht, kjo kategori subjektsh verifikohet një herë për pranimin në programin e formimit fillestar 3 vjeçar në Shkollën e Magjistraturës dhe një herë tjetër pas diplomimit për kualifikimin për emërimin si gjyqtarë.²⁶ Ky fakt tregon se procedura e verifikimit përsëritet në një kohë të shkurtër duke angazhuar disa institucione,²⁷ çka i mbingarkon për verifikimin e dokumentacionit ligjor dy herë, si: formulari i plotë i deklaratës së pasurisë, autorizimet e pasurisë, burimet financiare dhe deklaratat e aseteve dhe të interesave private. Për këtë qëllim, KShH vlerëson se procesi që ka rëndësi parësore është verifikimi i parë, para se këta shtetas të pranohen në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që gjatë ushtrimit të detyrës, ata do i nënshtrohen vlerësimit të rregullt etiko-profesional nga KLGJ dhe kontrollit të pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Në këtë këndvështrim, vlerësohet se do ishte me vend propozimi i ndryshimeve ligjore për lehtësimin e barrës administrative të institucioneve të përfshira, duke synuar përsheptimin e procesit të emërimit të gjyqtarëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Emërimet e ndihmësve ligjorë

Në lidhje me procedurat e emërimit të ndihmësit ligjor, nga data e kualifikimit të kandidatit për formimin në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e miratimit për vijimin e procedurës në shërbimin civil, periudha ka variuar sipas rasteve të marra në analizë nga 6 muaj²⁸ deri në 17 muaj²⁹. Procedura e kualifikimit të kandidatit për formimin në Shkollën e Magjistraturës është procedurë që administrohet nga Shkolla e Magjistraturës, në mënyrë të pavarur nga procedura për pranimin në shërbimin civil gjyqësor. KShH gjen rastin të theksojë rëndësinë për zhvillimin e karrierës së nëpunësve civilë gjyqësorë, në mënyrë të veçantë për pozicionin e ndihmësve ligjorë, për të cilët është e rëndësishme të garantohen standardet e procedurave efikase, rigorozë dhe uniforme, si vendimtare për menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve në këto gjykata.

2. Komandimet e gjyqtarëve

E drejta ndërkombëtare nuk parashikon rregullime mbi komandimin e magistratëve në veçanti. Për rregullimin e posaçëm për komandimin zbatohen standardet e detyrueshme lidhur me statusin e magistratëve.³⁰ Gjyqtarët në skemën e komandimit në pritje për t'u caktuar pranë një gjykate shërbejnë në strukturat administrative të institucioneve të drejtësisë, si dhe i respektohet

²⁵<https://ëëë.reporter.al/2023/10/11/klgj-kujtohet-te-emeroje-40-magjistratet-e-rinj>

²⁶Sipas nenit 32 dhe nenit 35 të Ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Shih Vendimin e KLGJ nr.606, datë 04.12.2020

²⁷Shkolla e Magjistraturës; ILDKPKI-ja; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Byroja Kombëtare e Hetimit (SPAK); Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor; Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme.

²⁸Sipas Vendimit nr.504, datë 28.09.2023

²⁹Vendimit nr. 508, datë 05.10.2023 procedurat për pranimin e ndihmësit ligjor

³⁰Për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit.

vazhdimësia e shërbimit në to. Ndërsa komandimi për magjistratë në pozicionin e këshilltarit ligjor bëhet në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese.

Gjetje: Në vitin 2023, KLGJ ka miratuar për komandimin e magjistratëve 28 akte (*individuale dhe kolektive*), rreth 4 herë më shumë se në vitin 2022.³¹ Evidentohen 19 akte individuale dhe 7 akte kolektive për hapje procedure për komandimin e gjyqtarëve,³² për përfundimin e komandimit apo komandimin e gjyqtarëve. Në vitin 2023 janë komanduar 10 gjyqtarë, sipas kategorizimit në vijim:

4 gjyqtarë si ndihmës magjistratë në Gjykatën e Lartë dhe 1 në Gjykatën Kushtetuese;

1 gjyqtar në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë;

1 gjyqtar në njësitë për vlerësimin në KLGJ;

1 gjyqtar në Ministrinë e Drejtësisë;

1 gjyqtar në GJEDNJ;

1 gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës;

Nga analiza e akteve rezulton se vendimet e KLGJ-së për komandimet janë të arsyetuara dhe reflektojnë transparencën e procedurave të ndjekura.³³ Skema e komandimit për vitin 2023 ka ndihmuar kryesisht Gjykatën e Lartë për plotësimin e vakancave me ndihmës magjistrat, si dhe Gjykatën Kushtetuese për plotësimin e numrave me ndihmësgjyqtarë. Në kushtet kur sistemi gjyqësor po përballlet me vakanca në rradhët e gjyqtarëve dhe vonesa në gjykimin e çështjeve dhe fondit të backlog, për KShH-në është e diskutueshme komandimi i gjyqtarëve jashtë sistemit gjyqësor.³⁴

3. Skema për delegimin e gjyqtarëve

Skema e delegimit³⁵ i njeh gjyqtarëve me të paktën një vit përvojë në funksion, të drejtën për t'u caktuar në një pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, sipas nevojave të një gjykate për një periudhë që më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 5 vjet. Caktimi në një skemë delegimi bëhet me kërkesën e vetë gjyqtarëve.³⁶

Gjetje: Gjatë vitit 2023, sipas raportit të KZHK ka pasur gjithsej vetëm 12 akte individuale për delegim, ndër të cilat ka pasur në total 5 caktime të gjyqtarëve në skemën e delegimit pranë

³¹Në vitin 2022 ka pasur 6 komandime gjithsej.

³²4 akte kolektive janë miratuar për hapjen e procedurave për komandimin e gjyqtarëve si ndihmës magjistratë, si gjyqtarë në Shkollën e Magjistraturës apo si nëpunës në KLGJ

³³Vendim nr.226, datë 08.05.2023 për përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës e Magjistraturës; Vendim nr.730, datë 07.12.2023, Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "ndihmësmagjistrat" në Gjykatën Kushtetuese

³⁴<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/02/Dritehijet-dhe-Efektet-e-Hartes-se-Re-Gjyqesore.pdf>

³⁵ Sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 45 të Ligjit "Për statusin".

³⁶Sipas nenit 47 të Ligjit "Për statusin".

Gjykatës Administrative të Apelit, për shkak të vakancave të shumta pranë kësaj gjykate dhe nevojës për të ruajtur funksionalitetin e saj. Ndërkohë, në janar 2023 për shkak të hartës gjyqësore përfunduan skemën e delegimit, gjyqtarët në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Nga analiza e një prej akteve, rezulton se KLGJ ka vendosur për pranimin e kërkesës së gjyqtares për vendosjen në skemën e delegimit, procedurë që ka zgjatur 3 muaj³⁷. Kjo periudhë përfshin të gjitha hapat proceduriale sipas vendimit të KLGJ nr.22, date 7.02.2019 “Për skemën e delegimit”, që parashikon se menjëherë pas marrjes së kërkesës nga gjyqtarja për caktimin në skemën e delegimit, KZHK merr vendim paraprak në lidhje me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe i dërgon Këshillit propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës. Rezulton se Këshilli ka zhvilluar shortin brënda 3 ditëve nga marrja e kërkesës nga kryetari i gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, sipas listës së gjyqtarëve të përfshirë në skemën e delegimit. Për këtë rast, gjyqtares i është pranuar kërkesa për përfshirje në skemën e delegimit për një periudhë 3 vjet.³⁸ Kjo skemë i lejon gjyqtarëve të gëzojnë të drejtën e kompensimit gjatë periudhës 3-vjeçare, pas caktimit në një gjykatë tjetër.

KShH vlerëson se kjo skemë është e vlefshme të përdoret në mënyrë të veçantë për plotësimin e pozicioneve të hapura në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, për të cilat nuk mund të procedohet me transferimet e gjyqtarëve për të plotësuar vakancat e përkohshme.³⁹

4. Transferimet e gjyqtarëve

Standarde ndërkombëtare⁴⁰: një gjyqtar që ushtron funksionin në një gjykatë, në parim nuk mund të caktohet në një tjetër gjykatë, pa dhënë lirisht pëlqimin e tij.⁴¹ Përfshirja nga ky rregull lejohet vetëm kur transferimi parashikohet dhe është shprehur si sanksion disiplinor, në rastet e një ndryshimi të ligjshëm të sistemit gjyqësor dhe në rastet e caktimit të përkohshëm të gjyqtarit, për të përforcuar një gjykatë fqinje, me kohëzgjatje maksimale të përcaktuar rigorozisht nga ligji.

Nisur nga kërkesat e veçanta që kërkon rregjimi për transferimin e përkohshëm në drejtim të respektimit të pavarësisë së gjyqtarëve, KLGJ duhet të justifikojë mjaftueshëm çdo vendim të tij për transferimin e gjyqtarëve, që shpjegon mënyrën se si janë përmbushur kushtet, kur nevojat e gjykatës nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së zhvillimit të karrierës së magistratëve dhe “kur?” dhe “pse?”m transferimi gjykohet si mjeti më i përshtatshëm për këtë qëllim.⁴²Në këtë

³⁷ Me anë të vendimit nr.538, datë 12.10.2023.

³⁸Vendim nr. 538, datë 12.10.2023 “Për cakimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”

³⁹Sipas pikës 8 të nenit 42 të Ligjit “Për Statusin”.

⁴⁰Këshilli i Evropës, Karta Evropiane “Mbi Statusin e Gjyqtarit dhe Memorandumit Shpjegues”, Strasburg, 8-10 Korrik 1998 , pika 3.4, [https://ecd.coe.int/VieDoc.jsp?p=&Ref=DAJ/DOC\(98\)23&Language=lanAlbanian&Ver=original&Site=COE&BackColorInternet=BDDBCF2&BackColorIntranet](https://ecd.coe.int/VieDoc.jsp?p=&Ref=DAJ/DOC(98)23&Language=lanAlbanian&Ver=original&Site=COE&BackColorInternet=BDDBCF2&BackColorIntranet)

⁴¹Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve (ShNgj), Karta Universale të Gjyqtarit, 1999, Neni 8; <https://eëë.icj.org/ép-content/uploads/2014/03/IAJ-Universal-Charter-of-the-Judge-instruments-1989-eng.pdf> ; Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Shteteve Antëtare Për Pavarësinë, Eficientë dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarëve, Këshilli i Evropës, RCM/Rec(2010)12,2010, Kapitulli IV Pika 52, Kreu VI “Statusi i gjyqtarit”, [https://eëë.coe.int/t/dghl/standardsetting/cdcj/CDCJ%20Recommendations/CMRec\(2010\)12E_%20judges.pdf](https://eëë.coe.int/t/dghl/standardsetting/cdcj/CDCJ%20Recommendations/CMRec(2010)12E_%20judges.pdf)

⁴² Vendim nr. 23, datë 07.02.2019 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”:

drejtim çdo vendim për transferimin e gjyqtarit duhet ti përgjigjet kërkesave të ligjit për të garantuar të drejtën e gjyqtarit për të mos u lëvizur nga detyra, në mënyrë që ti garantohen pavarësia, paanshmëria dhe eficientia e gjyqësorit.⁴³ Sipas konstatimeve të bëra nga KLGJ nëpërmjet këtij raporti, rastet kur nuk merret pëlqimi i gjyqtarit janë shprehimisht të përcaktuara në ligj, si: riorganizimi i ligjshëm i sistemit të gjykatave për mbylljen e një gjykate ose kur kërkohet për të ndihmuar punën në një gjykatë tjetër (*Neni 44 i ligjit për statusin*). Kjo kërkesë e ligjit është përmbushur në çdo procedurë transferimi, ku përveç rasteve të transferimeve pa pëlqim që jepen si masë disiplinore ose për shkak të suprimimit të pozicionit, në rastet e transferimeve me pëlqim merret gjithmonë pëlqimi i gjyqtarit.

Gjetje: Për vitin 2023 rezulton se KLGJ ka miratuar gjithsej 68 akte administrative për transferimet (24 akte *individuale dhe 44 akte kolektive*), nga të cilat ka vendosur në total për 57 transferime të gjyqtarëve dhe kancelarëve. Krahasuar me vitin 2022, janë rreth 6 herë më shumë transferime për vitin 2023,⁴⁴ nga të cilat janë marrë në analizë këto akte të KLGJ-së:

Aktet kolektive për shpalljen e hapjes së procedurave për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes për transferimin e përkohshëm në një pozicion të lirë *në gjykatat Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë*.

Aktet individuale për transferimin e gjyqtarëve me zgjedhje, për transferimin e përkohshëm me pëlqim dhe për transferimin e përhershëm të kancelarëve janë veçanërisht për transferimin e gjyqtarëve, për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të suprimimit të gjykatës, për transferimin e përhershëm të kancelarëve, për transferimin e përkohshëm me pëlqim si dhe për përsëritjen e transferimit.

Në vijimësi janë analizuar 15 akte të përzgjedhura për transferimet:⁴⁵

1 akt për shpalljen e hapjes së procedurës së transferimit me pëlqim,

2 akte për transferim të përkohshëm,

3 akte për transferim me përsëritje,

4 akte për përfundimin e transferimit para afatit;

⁴³Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

⁴⁴Gjatë vitit 2022, KLGJ-ja ka vendosur transferimin e përkohshëm të 1 gjyqtari si dhe ka përsëritur transferimin e përkohshëm të 8 (tetë) gjyqtarëve për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

⁴⁵Vendim nr.98, datë 06.03.2023 për transferimin e përkohshëm me pëlqim në gjykatën e rrethit gjyqësor durrës të gjyqtarit z. {...};Vendim nr.97, datë 06.03.2023 për transferimin e përkohshëm me pëlqim në gjykatën e rrethit gjyqësor tiranë të gjyqtarës znj. {...};Vendim nr.220,datë 28.04.2023 për transferimin e gjyqtarit {...}, në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm lezhë;Vendim nr.219,datë 28.04.2023 për transferimin e gjyqtarës {...},në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm elbasan;Vendim nr. 110, datë 13.03.2023 për transferimin e gjyqtarit z. {...}, në gjykatën e rrethit gjyqësor tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale; Vendim nr. 80, datë 16.02.2023 për transferimin e ndihmësit ligjor z. {...}, në njësinë e shërbimit ligjor pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm tiranë Vendimi nr. 530, datë 11.10.2023 për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit

Transferimet e përkohshme me pëlqim

KL Gj, për shkak të vakancave, ka shpallur transferimin e përkohshëm të gjyqtarit në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë (7 pozicione), Durrës (3), Gjirokastrë (1), Elbasan (1), gjykata administrative e shkallës së parë Vlorë dhe gjykata administrative e rrethit Tiranë (1 pozicion respektivisht). KL Gj ka vendosur për dy raste përsëritjen e transferimit për një periudhë tjetër 1-vjeçare, si dhe për dy raste përfundimin e transferimit të përkohshëm para afateve të transferimit. Rezulton se aktet për shpalljen e procedurës për transferimin e gjyqtarëve nuk argumentojnë në përmbajtjen e tyre se cilat janë rrethanat konkrete mbi bazën e treguesve të ngarkesës së gjykatës, apo numrit të vakancave që kanë çuar në nevojën e transferimeve të përkohshme të gjyqtarëve për 1 vit. Të vetmet shpjegime ofrohen në raportin e KZHK-së, i cili i justifikon këto rrethana me nevojën për mospengimin e drejtësisë.⁴⁶ Sipas sqarimeve të KL Gj-së në lidhje me këtë konstatim të KShH-së, çdo vendimmarrje e KL Gj-së shoqërohet me relacionin përkatës në të cilin janë të analizuar hollësisht të dhënat dhe faktet dhe gjetjet që çojnë në vendimmarrje. Relacioni bëhet objekt diskutimi në Komision apo në Mbledhjen Plenare të Këshillit. Por këto relacione nuk janë të aksesueshme për publikun, në faqen zyrtare të Këshillit.

Ndërsa në aktet për transferimin e përkohshëm nuk argumentohen disa aspekte të rëndësishme të vendimmarrjes, si kriteret ligjore që duhen përmbushur mbi përzgjedhjen e gjyqtarëve që kërkojnë të transferohen, si: (1) sa ka qënë numri i kërkesave për secilin pozicion vakant në secilën prej gjykatave, (2) si janë përmbushur kriteret nga secili prej tyre, (3) cili është efekti që krijon transferimi tek gjykatat e gjyqtarëve që transferohen, (4) cila do jetë dobia e gjykatës pritëse etj. Mungesa e një analize individuale të secilit akt, i cili duhet të jetë i arsyetuar krijon premisa për elementë të natyrës së korporatizmit në procesin e transferimeve, i cili duhet të jetë sa më transparent dhe i besueshëm për publikun. Kjo analizë mungon dhe në raportin e KZHK-së,⁴⁷ e cila mjaftohet vetëm me të dhëna sasiore për këto vendime, por nuk pasqyron detaje të dhënash cilësore për të kuptuar më tej ecurinë e këtyre procedurave. KL Gj sqaron në lidhje me këtë se ecuria e procedurës së transferimit dhe të gjitha gjetjet pasqyrohen në aktin relacionit, për të cilin KShH ripërsërit qëndrimin se është i paaksesueshëm për publikun në faqen e Këshillit.⁴⁸

Përsëritja e transferimeve të përkohshme me pëlqim

Për dy rastet e transferimeve me përsëritje, procedurat janë kryer konform rregullores dhe përmbushin marrjen e pëlqimit të gjyqtarit për zgjatjen e periudhës me 1 vit. Në lidhje me këtë, KShH inkurajon vazhdimësinë e zbatimit sa më të moderuar të përsëritjes së transferimeve të përkohshme “me pëlqim”, të cilat duhet të balancohen me mënyra të tjera të zhvillimit të karrierës

⁴⁶ Referuar vendimeve nr. 25 – 30, datë 18.01.2023 për shpalljen e procedurës, vendimeve respektive për transferimin, si dhe raportit të KZHK-së në lidhje me transferimet e përkohshme me pëlqim.

⁴⁷ Shih raportin I KZHK për vitin 2023, faqe 22

⁴⁸ <https://klgj.al/ep-content/uploads/2023/02/NJOFTIM-I-DAT%C3%8BS-06.02.2023-MBI-KANDIDATURAT-E-PARAQITURA-N%C3%8B-PROCEDURAT-E-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-P%C3%8BRKOHSH%C3%8BM-1.pdf>

së gjyqtarëve, për shkak se transferimet e përsëritura ndikojnë në cënimin e autonomisë gjyqësore dhe besueshmërisë së figurës së gjyqtarit.

Transferimet e përhershme me zgjedhje të gjyqtarëve⁴⁹

Sipas raportit të KZHK-së transferimet e përhershme të gjyqtarëve me zgjedhje i përgjigjen kërkesave për të balancuar interesat e qytetarëve në drejtim të aksesit në drejtësi, duke menaxhuar njëkohësisht dhe vakancat në sistem, referuar parashikimeve për transferimet e gjyqtarëve.⁵⁰ Më konkretisht: zbatimin e hartës së re gjyqësore, për shpërndarjen e gjyqtarëve nga gjykatat e suprimuara; nevojën për plotësimin e vendeve vakante të krijuara në gjykata për shkak të procesit të vetingut; garantimin e karrierës së gjyqtarëve.

Nga aktet e KLGJ-së rezulton se ka disa vendime në formën e akteve individuale për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve në mënyrë të përhershme, të cilat i njohin gjyqtarët me alternativat e gjykatave ku mund të transferohen dhe të drejtën për të shprehur zgjedhjen e tyre. Ndërsa në këto vendime evidentohet respektimi i zgjedhjes së gjyqtarëve dhe parashikohet e drejta e ankimit të gjyqtarëve kundrejt vendimit brenda afatit 15 ditë nga marrja e tij, nga verifikimi i akteve të përzgjedhura për t'u analizuar nga KShH, rezulton se në të gjitha rastet procedura për transferimet me zgjedhje janë kryer brenda të njëjtës ditë me shpalljen e procedurës së transferimit. KShH vlerëson se përfundimi i procedurës brenda të njëjtës ditë me shpalljen e vendimit i jep procesit një karakter ngushtësisht formal dhe të paracaktuar në rezultatin e tij. Po ashtu, është e paqartë si janë përzgjedhur gjykatat e rretheve gjyqësore për të cilat bëhet propozimi për transferim në respektim të kriterëve që KLGJ propozon për secilin gjyqtar që ka një pozicion të përhershëm në gjykatën që shkrihet. Mungesa e këtij argumentimi është në dëm të transparencës ndaj publikut dhe çdo pale të interesuar brenda sistemit gjyqësor. Vlen të përmenden në këtë analizë edhe konstatimet e mëparshme të KShH në raportin e tij të parë për hartën e re gjyqësore, sipas të cilit aktet administrative individuale të KLGJ-së në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës sipas nenit 98, pika 2 e ligjit nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së drejtësisë”*. Ky arsyetim, vijon të jetë i munguar në vlerësimin e KShH-së.

4. Caktimet e gjyqtarëve në çështje të veçanta në gjykata të tjera

Lidhur me këtë instrument gjejnë zbatim rregulla të veçanta sipas Vendimit Nr. 30/2019 të KLGJ për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

⁴⁹Vendimi nr. 57, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Gilda Hoxha, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”; Vendimi nr. 58, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Lorena Çabej, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”; Vendimi nr. 59, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Marçela Shehu, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”; Vendimi nr. 110, datë 13.03.2023 “Për transferimin e gjyqtarit z. Ardit Mustafaj, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”; Vendimi nr. 218, datë 28.04.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Diamela Goxha, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile”; Vendimi nr. 219, datë 28.04.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Yrfet Shkreli, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”; Vendimi nr. 220, datë 28.04.2023 “Për transferimin e gjyqtarit Gentian Marku, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”; Vendimi nr. 221, datë 28.04.2023 “Për transferimin e gjyqtarës Flutura Hoxha, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

⁵⁰Neni 135, 147 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, 162 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve ...”, i ndryshuar

Gjetje: Për vitin 2023, KLGJ ka miratuar 32 akte kolektive për caktimet e gjyqtarëve në çështje të veçanta në një gjykatë tjetër. Nga verifikimi i akteve rezulton se ka pasur kërkesa të shumta të gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera.⁵¹ Vendimet⁵² merren me efekt të menjëhershëm, duke evidentuar plotësimin e kushteve, kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave⁵³.

Përgjatë vitit 2023, në numrin e kërkesave për caktim gjyqtari ka ndikuar zbatimi i hartës së re gjyqësore, si mjet për të zëvendësuar transferimet e gjyqtarëve për të ulur ngarkesën e gjykatave⁵⁴. KZHK ka trajtuar 169 kërkesa për caktim gjyqtari nga kryetarët respektiv të gjykatave, me motivacionin se janë në pamundësi për shqyrtimin e tyre, nga të cilat:

139 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore (*përfshirë edhe gjykatën e posaçme të shkallës së parë*),

25 kërkesa të ardhura nga gjykatat administrative (*përfshirë edhe apelin administrativ*),

5 kërkesa të ardhura nga gjykatat e apeleve (*përfshirë edhe gjykatën e posaçme të apelit*).

Nga verifikimi i akteve të përzgjedhura për caktimet në këtë raport⁵⁵ rezulton se pavarësisht referimit formal të kriterëve ligjorë⁵⁶, në këto akte nuk jepen të dhëna mbi mënyrën se si respektohen kriteret e afërsisë gjeografike, ngarkesës së gjyqtarëve që caktohen, nëse gjyqtari është caktuar në më shumë se një gjykatë, apo për të gjykuar më shumë se një çështje në të njëjtën gjykatë. Kjo mungesë në arsyetim vazhdon të jetë një problem dhe në aktet e KLGJ-së për këtë kategori të vendimeve, të cilat duhet të respektojnë standartin e ligjshmërisë.

⁵¹Vendimi i KLGJ nr. 269, datë 24.05.2023 “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastrë, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë”

⁵²Vendim nr. 662, datë 02.11.2023 “Për caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit; Vendim nr.524, datë 05.10.2023 “Për caktimin e gjyqtarëve në gjykatën e rrethit Lezhë, Berat, dhe Gjirokastrë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 484, datë 13.09.2023”Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 471, datë 26.07.2023”Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

⁵³Vendimi i KLGJ nr.269, datë 24.05.2023 “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të rrethit gjyqësor Kavajë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Gjirokastrë, Kukës, Pukë, Kurbin, Lezhë, Krujë”.

⁵⁴ Raporti i KZHK për vitin 2023, faqe 29.


⁵⁵Vendim nr. 662, datë 02.11.2023 për caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit; Vendim nr.524, datë 05.10.2023, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi caktimi në gjykatën e rrethit Lezhë, Berat, dhe Gjirokastrë;55 Vendim nr. 484, datë 13.09.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 471, datë 26.07.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 469, datë 25.07.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

⁵⁶ Vendim Nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit mbi rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”

5. Lëvizjet paralele

KZHK përgjatë vitit 2023 ka përdorur lëvizjen paralele si një nga format e transferimit të gjyqtarit për të adresuar nevojat e sistemit të drejtësisë, por edhe për të garantuar të drejtën e tyre për ecurinë në karrierë.

Gjetje: Në lidhje me aktet për lëvizjet paralele rezultojnë në total 104 akte kolektive dhe individuale, ku në gjysmën e parë të vitit ka pasur rreth 2-3 herë më shumë akte krahasuar me gjysmën e dytë. Aktet kolektive janë kryesisht për renditjen e kandidatëve, për verifikimin e kriterëve për kandidatët dhe për fillimin e lëvizjes paralele. Ndërsa aktet individuale janë për kualifikimin e kandidatëve për lëvizjen paralele dhe për përfundimin e këtyre procedurave. Më konkretisht janë hapur procedura të lëvizjes paralele për pozicionet e reflektuara në grafikun si më poshtë:



Nga tërësia e akteve të përzgjedhura figuron se procedurat në përgjithësi përmbushin kriteret ligjore për shpalljen e pozicionit, afatin e kandidimit, verifikimin⁵⁷ dhe kualifikimin e kandidatëve.⁵⁸ Vendimet gjithashtu pasqyrojnë listimin e kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale, verifikimin e tre kriterëve, kualifikimin e kandidatëve etj. Po ashtu, rezulton se kandidatëve iu garantohet e drejta për të përjashtuar relatorin nëse kanë arsye, si dhe e drejta e ankimit të vendimit brenda 15 ditëve.

Nga ana tjetër, vërehet se procedurat për lëvizjet paralele janë të ndërvarura dhe nuk marrin parasysh afate të përcaktuara qartë për kohëzgjatjen e tyre, përveç afateve që parashikohen për

⁵⁷Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013, KLGJ ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë ku , Vendimi nr.11 deri vendimin nr.20 datë 18.01.2023 janë për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

⁵⁸Vendim 521/2023 “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile”; Vendim 517, datë 05.10.2023 “Për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

fillimin e procedurës së verifikimit që është 7 ditë nga data e mbylljes së kandidimit, si dhe afatin për marrjen e vendimit të caktimit të kandidatit për lëvizje në detyrë që është 7 ditë nga data e miratimit të renditjes së kandidatëve. Procedurat janë të ndërlidhura në 3 faza që kanë objekt dhe kohëzgjatje të ndryshme.

Nga aktet e përzgjedhura për analizë në këtë raport rezulton se tërësia e procedurave të tilla varion nga 6 muaj për kandidatët që nuk kanë aplikuar për pozicion tjetër deri në 10 muaj për ato që kanë aplikuar për disa pozicione. Në dijeni të faktit se për vitin 2023 ka pasur aplikime për 25 pozicione të lira, nga të cilat ka pasur 15 tërheqje nga kandidimi për lëvizje paralele nga 40 kandidatët që kanë aplikuar, një situatë e tillë krijon premisa që këto procedura të komplikohen dhe të ecin më hapa të ngadaltë. Rrjedhimisht, KShH vëren se dhe për procedurat për lëvizje paralele mund të krijohen mekanizma që synojnë sinkronizimin e tre fazave të ndërvarura të procedurave administrative, për të menaxhuar mbarëvajtjen tërësore të procesit duke evituar sa më shumë të jetë e mundur shkaqet që ngadalësojnë procesin. Gjithashtu mund të përmirësohet përmbajtja e vendimeve të KLGJ-së për këto procedura, në mënyrë që të jenë më transparente dhe të arsyetuara për publikun. Në dijeni të faktit se procedura të tilla kanë impakt të dukshëm në menaxhimin e hapjes së vakancave për caktimin e përhershëm të magjistratëve në gjykata, mund të konsiderohen parashikime të reja në aktet e KLGJ-së⁵⁹ për rregullimin e afateve ligjore për ecurinë e 3 (tre) fazave procedurale, në mënyrë që të krijohen dhe premiset për menaxhimin e tyre sa më efikas. Kjo kërkesë është dukshëm më e lartë sidomos për gjykatat e karrierës, ku numri i kandidatëve ka qënë tejet i lartë dhe për të cilat nevojat për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve janë gjithashtu më evidente.

6. Ngritjet në detyrë

Sipas kuadrit ligjor në fuqi procedura e ngritjes në detyrë ka si objekt krijimin e disa standarteve të qartësisë dhe parashikueshmërisë së procedurave dhe bazohet në vlerësime periodike të performancës profesionale.⁶⁰ Për këtë skemë zbatohen rregulla të veçanta në Gjykatën e Posaçme Antikorrupsion dhe koha e komandimit përfshihet në periudhën e vjetërsisë.

Standarte ndërkombëtare: proceset e skemës së zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve sidomos për rekrutimin, përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve kërkojnë procedura që të jenë të drejta, të hapura dhe transparente, me termat e referencës të publikuara në të gjitha fazat. Në përzgjedhjen e kandidatëve inkurajohet diversiteti për të shmangur diskriminimin, por jo domosdoshmërisht për të vendosur kuota. I gjithë procesi duhet të jetë i hapur për opinionin publik, ku kandidatët informohen mbi arsyet e moszgjedhjes me vendim.⁶¹

⁵⁹Vendim nr. 320, datë 17.09.2020 për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve

⁶⁰I referohet parashikimeve ligjore të kushtetutës (neni 147/a, 149a), ligjit për statusin (neni 48-52)

⁶¹Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore ii 2011 – 2012 rrjeti evropian i këshillave për gjyqësorin (treguesit që lidhen me standardet minimale në lidhje me rekrutimin, përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin e anëtarëve të gjyqësorit)https://ec.europa.eu/images/stories/pdf/ga/dublin/final_report_standards_ii.pdf

Gjetje: Për vitin 2023, KLGJ ka miratuar në total 96 akte administrative për ngritje të magjistratëve në detyrë, nga të cilat 73 akte individuale dhe 23 akte kolektive. Aktet kolektive janë për hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë, për renditjen e kandidatëve, për nisjen e procedurës së fillimit dhe verifikimit të kriterëve. Aktet individuale janë për verifikimin e kriterëve për ngritjen në detyrë, për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kandidatëve (1 në gjykatën e apelit juridiksioni i përgjithshëm dhe 1 në gjykatën e posaçme shkalla e parë), si dhe për kualifikimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë.

Për vitin 2023, KLGJ ka marrë vendime për ngritjet në detyrë të gjyqtarëve për pozicionet e hapura që në vitin 2020-2021, 2022 dhe 2023 në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ, si më poshtë:

Në vitin 2020 – 2021 janë shpallur 4 pozicione në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁶² dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ⁶³, 12 pozicione të lira në Gjykatën e posaçme⁶⁴, (për të cilat nuk ka pasur asnjë kandidat) dhe 3 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë⁶⁵.

Në vitin 2022 janë shpallur 3 pozicione të lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm,⁶⁶ për të cilat ka pasur 22 kandidatë, janë shpallur 3 pozicione të lira⁶⁷ në Gjykatën e posaçme për të cilat ka pasur 14 kandidatë dhe është shpallur një pozicion i lirë në Gjykatën e Lartë.⁶⁸

Në vitin 2023 janë shpallur 9 pozicione të lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁶⁹ për të cilat ka pasur 30 kandidatë dhe janë shpallur 4 pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Administrativ, për të cilën ka pasur 11 kandidatë.⁷⁰

Nga analiza e 7 akteve të përzgjedhura për t'u analizuar në këtë raport⁷¹ rezulton se procedurat administrative për marrjen e vendimeve për kualifikimin e ngritjes në detyrë zgjasin përgjithësisht 6 muaj, por ka variuar në disa raste nga 8 muaj⁷² deri në 2 vjet e 5 muaj.⁷³ Sipas vendimit të KLGJ-së nr.585, datë 18.10.2023, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore lidhet me hapjen e tre pozicioneve në fushën penale në Gjykatën e Apelit (*në vitin 2020*), të cilat kanë qënë jo të njëjta për 11 kandidatët dhe përfundimi i tyre varion nga muajt Prill - Nëntor 2021. Më tej, pas verifikimit

⁶² Vendim i KLGJ-së nr. 183, 184, 185 datë 28.05.2020.

⁶³ Vendim i KLGJ-së nr. 290, datë 6.07.2021; Vendim i KLGJ-së nr. 129, datë 1.04.2021; Vendim i KLGJ-së nr.571, datë 7.12.2021.

⁶⁴ Vendim i KLGJ nr. 128 datë 01.04.2021 Për pozicion e lirë, Vendim i KLGJ nr. 123 datë 01.04. 2021 dhe Vendim i KLGJ nr. 287 datë 06.07.2021 “Për pozicionin e lirë”

⁶⁵ Vendimete KLGJ-së nr. 535 nr. 536 nr. 537 datë 17.11.2021

⁶⁶ Vendim i KLGJ-së 502,503,504, datë 21.11.2022.

⁶⁷ Vendim i KLGJ-së 499, nr.500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022,

⁶⁸ Vendim i KLGJ-së nr. 178 datë 11.05.2022

⁶⁹ Vendim i KLGJ-së 239-247, datë 21.05.2023

⁷⁰ Vendim i KLGJ-së 235-238, datë 24.05.2023.

⁷¹ Vendim i KLGJ-së nr. 57, datë 07.02.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore; Vendim i KLGJ-së nr.122, datë 15.03.2023 “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë; Vendim i KLGJ-së nr.293, datë 30.05.2023, “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati”; Vendim i KLGJ-së 516/datë 05.10.2023 “Për renditjen e kandidatëve për ngritje në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm tiranë; Vendim i KLGJ-së nr.357, datë 06.07.2023 “Për kualifikimin e kandidatëve”; Vendim i KLGJ-së nr. 492, datë 21.09.2023 “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë”; Vendim i KLGJ-së nr.585, datë 18.10.2023 për ngritjen në detyrë.

⁷² Vendim i KLGJ-së nr.357, datë 06.07.2023; Vendim i KLGJ-së nr. 492, datë 21.09.2023

⁷³ Vendim i KLGJ-së 516/datë 05.10.2023; vendimi nr.585, datë 18.10.2023

të kriterëve në 2021 e deri në daljen e vendimit në 2023, ecuria e procesit ka përfshirë vlerësimin etik profesional dhe vlerësimin e pasurisë dhe figurës. Lidhur me këtë procedurë, KLGJ ka sqaruar se tejzgjatja në këtë rast kanë ardhur pasi nevojiteshin dy vlerësime etike e profesionale. Në kushtet kur gjyqtari i ngritur në detyrë ka qene i komanduar në KLGJ ishte e nevojshme pritja deri në miratimin e aktit nënligjor “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik e profesional të gjyqtareve në KLGJ” (Vendim nr. 159, 05.04.2023).

KShH vlerëson se çdo kohëzgjatje për ngritjen në detyrë të gjyqtarit mbi periudhën normale prej 6 muajsh, meriton të vlerësohet me kujdes, për të shmangur burokracitë e panevojshme dhe premisa për korporatizëm dhe ndikime të papërshtatshme në sistem. Në këtë pikë, ashtu sikurse pranohet dhe nga KLGJ, procedurat e ngritjes në detyrë janë komplekse në tërësinë e tyre, pasi ndërlidhen me procedura administrative që kërkojnë bashkëveprimin me institucione të tjera për verifikimin e pasurisë, për verifikimin e të dhënave për figurën e gjyqtarit, apo dhe për efekt të ndjekjes dhe pritjes së rezultateve të ankimimeve, të kryera nga ana e gjyqtarëve për garantimin e të drejtave të tyre në respektim të procedurave të vlerësimit. Po ashtu, mirëkuptohen ndikimet në kohëzgjatjen e procedurave për ngritjen në detyrë kur kandidatët janë gjyqtarë, subjekte në pritje të vendimmarrjes së procesit të vetingut. Sipas KLGJ-së, ka pasur disa raste zvarritjesh të procedurave për këtë shkak, për të cilat rregullimet ligjore nuk garantojnë koherencë pasi janë hartuar për situata normale dhe jo për situata të këtij lloji.

Ndërkohë, nga analiza e disa prej akteve të përzgjedhura vihet re se zvarritjet e këtyre proceseve ndikohen në mënyrë të pajustificuar nga vonesat që krijohen nga hapja e pozicioneve dhe deri në datën e fillimit të procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore. Disa raste të evidentuara janë si më poshtë:

Rreth 2 vite më vonë, për verifikimin e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e KLGJ-së nr. 287, datë 06.07.2021 në gjykatën e posaçme të shkallës së parë antikorrupsion, procedura e të cilave ka filluar më 13.07.2023.⁷⁴

Pas 9 muajsh për verifikimin e kandidatëve për pozicionet e hapura në datë 24.05.2023 në Gjykatën e Apelit Administrativ, për të cilat përzgjedhja ka filluar më datë 7.04.2024.⁷⁵

Pas 6 muajsh për verifikimin e kandidatëve për pozicionet e shpallura në datë 21.11.2022 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilët përzgjedhja ka filluar në datë 6.07. në 2023.⁷⁶

⁷⁴ Vendim i KLGJ-së nr. 372, datë 13.07.2023

⁷⁵ Vendim i KLGJ-së nr. 57, datë 07.02.2024

⁷⁶ Vendim i KLGJ-së nr.357, datë 06.07.2023

Pas 3 muajsh për verifikimin e kandidatëve për një pozicion tjetër të hapur në datë 21.11.2022 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilën përzgjedhja ka filluar në datë 9.02.2023.⁷⁷

Pas 6 muajsh për verifikimin e kandidatëve për pozicionin e hapur në datë 17.11.2021 në Gjykatën e Lartë, për të cilën përzgjedhja ka filluar në datë 27.05.2022.⁷⁸

Si rregull, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedurat për verifikimin e kritereve ligjore duhet të fillojnë jo më vonë se 7 ditë nga afati i kandidimit,⁷⁹ i cili shpallet jo më vonë se 2 javë nga data e publikimit të vendimit për hapjen e pozicioneve të lira. Ndërsa në gjykatat e tjera, ky afat për fillimin e verifikimit të kritereve ligjore për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve nuk gjen rregullim në vendimin e KLGJ-së nr.70, datë 07.02.2020, “*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*”, çfarë krijon premisë për mungesë të standardit të ligjshmërisë dhe pasigurisë juridike, sipas kërkesave për procesin e rregullt ligjor në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane (KEDNJ-së). Gjithashtu nisur nga fakti se magjistratët mund të kandidojnë deri në maksimum për 3 pozicione të lira, zvarritja e procesit mund të krijohet dhe për shkak të heqjes dorë të kandidatëve për një pozicion.

Një gjetje tjetër në analizën e këtyre akteve lidhet me faktin se motivimi i tërheqjes së një kandidati nga një pozicion i caktuar argumentohet vetëm në vendimin e përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë për të, por nuk evidentohet në të gjitha vendimet e tjera ndërmjetëse për hapat proceduriale. Në lidhje me këtë, KLGJ ka sqaruar se motivimi i tërheqjes së kandidatit nuk është i domosdoshëm gjatë arsyetimit të vendimarrjes së Këshillit duke qenë se është shprehje e vullnetit të vetë subjektit i cili mjaftohet thjeshtë me heqjen dore nga kandidimi pa arsye të specifikuar, një e drejtë të cilën ia njeh vetë ligji neni 64 pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative⁸⁰. Pavarësisht kësaj, KShH rithekson nevojën për një arsyetim sa më të detajuar të akteve individuale të KLGJ-së, për të ndihmuar transparencën ndaj publikut. Gjithashtu vlerësohet se një përmbledhje më e sintetizuar dhe më koncize e vendimeve për këtë proces rrit qartësinë dhe eviton përsëritjet e shpeshta duke rritur lexueshmërinë e kuptueshmërinë e tyre për publikun. Në të njëjtën kohë përmirëson përafrimin me standartet ndërkombëtare, të cilat kanë si qëllim rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë së proceseve që lidhen me emërimet e gjyqtarëve.

⁷⁷ Vendim i KLGJ-së nr. 66, datë 09.02.2023

⁷⁸ Vendim i KLGJ-së nr. 193, datë 27.05.2022

⁷⁹ Vendim i KLGJ-së nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë” (azhurnuar me vendimin nr. 528, datë 10.11.2021); Vendim i KLGJ-së nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

⁸⁰ “...Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative”.

7. Procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve

Procedurat disiplinore për gjyqtarët janë të rregulluara si nevojë për rritjen e përafrimit me standartet e Kushtetutës dhe ligjit, për të krijuar sa më shumë garanci për magjistratët kundrejt akuzave për shkelje disiplinore të pabazuara. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është hallka e parë e këtyre procedurave për hetimin administrativ ndërsa KLGJ shkarkon gjyqtarët kur konkludon për shkelje të rënda profesionale/etike ose dënime për krime. Nisur nga pesha që kanë procedimet disiplinore në statusin e magjistratit, institucionet përgjegjëse ILD dhe KLGJ janë të detyruara të respektojnë parime të rëndësishme të shtetit të së drejtës dhe të drejtave dhe lirive të njeriut për ekzekutimin dhe regjistrimin e masave disiplinore, pezullimin dhe përgjegjësinë penale dhe civile, si dhe veprimet disiplinore dhe apelimet.⁸¹

Gjetje: Gjatë vitit 2023 rezultoi se ka pasur 16 akte individuale në lidhje me procedimet disiplinore, sikurse janë aktet për caktimin e relatorit, për pezullimin e procedurës, për shfuqizimin e vendimit të ish KLD apo KLGJ, për mbylljen e procedimit disiplinor dhe për caktimin e seancës dëgjimore.

Nga mbledhjet plenare të publikuara në faqen zyrtare të KLGJ-së rezultoi se për fillimin e një procedimi disiplinor me kërkesën e ILD-së ka pasur shtyrje 5 herë⁸² për arsye objektive që lidhen me paaftësinë për shkak sëmundjeje të magjistratit të vërtetuar me raport mjekësor. Për këtë rast, KLGJ i ka kërkuar ILD-së vijimin e procesit në mungesë të magjistratit, duke vendosur gjykimin në mungesë dhe caktimin e një përfaqësuesi ligjor kryesisht të magjistratit. Në këtë drejtim, KShH e shikon të arsyeshme të evidentojë nevojën për bashkërendimin e masave midis dy institucioneve, për evitimin e shtyrjeve të procesit disiplinor, për raste të ngjashme në të ardhmen. Gjithashtu, vlen të theksohet se përmirësimi i transparencës dhe aksesit të seancave plenare të KLGJ-së ka një rëndësi të lartë nga pikëpamja e respektimit të standartit të procesit të rregullt ligjor.

Përgjatë vitit 2023, tërheq vëmendje fakti se nuk ka pasur asnjë vendim nga ana e KLGJ-së qoftë për caktim të masës disiplinore, apo për përfundimin e procedimit disiplinor. KLGJ ka publikuar disa vendime të viteve të mëparshme të cilat bëhen publike menjëherë pas marrjes formë të prerë,⁸³ të cilat respektojnë anonimatit dhe rezultojnë të jenë të arsyetuara në mënyrë të detajuar. Arsyetimi i vendimeve të KLGJ-së por dhe të institucionit të ILD-së në rast të rrëzimit të kërkesës për procedim disiplinor, apo të vendimeve për caktimin e masës disiplinore është i nevojshëm për transparencën karshi publikut. Për këtë qëllim rekomandohet të krijohet në faqen zyrtare të KLGJ-së një rubrikë e dedikuar vetëm për procedimet disiplinore, ku të identifikohen lehtësisht seancat

⁸¹E drejta për një proces të rregullt, Parimin e ligjshmërisë, Parimin e akuzës, Parimin e barazisë para ligjit, Presumimin e pafajësisë, Parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor, Parimin e proporcionalitetit, Parimin e pavarësisë dhe paaftësisë së institucioneve disiplinore, Parimi për respektimin e pavarësisë së magjistratit, Parimin e drejtësisë së hapur, Parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private, Parimin përmbrojtjen e të dhënave personale.

⁸²Procedimi disiplinor i regjistruar me nr. 3/2022, për shqyrtimin e të cilit janë shtyrë 5 mbledhje plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 06.03.2023, 5.04.2023 për arsye objektive që lidhen me paaftësinë për shkak sëmundjeje, të vërtetuar me raport mjekësor; Mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor më 05.04.2023 (Pikat 1, 2, 3).

⁸³Vendime të cilat kanë kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit deri në shqyrtimin në Gjykatën Kushtetuese (GJK)

dëgjimore dhe procesverbalet e mbledhjeve plenare të KLGJ-së, për diskutimin e procedimeve disiplinore të gjyqtarëve, si dhe vendimmarrjet përkatëse lidhur me to. KShH përshendet faktin se KLGJ ka vlerësuar një rekomandim të tillë si të drejtë për tu përmbushur në të ardhmen.

Nga analiza e akteve të përzgjedhura, KShH vëren me shqetësim një praktikë të konsoliduar të KLGJ-së dhe ILD-së për mbylljen e procedimeve disiplinore, për shkak të parashkrimit të shkaqeve, kur çështja është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë (MD), në referim të ligjit të mëparshëm. Kështu, sipas një rasti⁸⁴ për procedimin disiplinor ndaj një magjistrati, në vitin 2012 Ministria e Drejtësisë kishte propozuar masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” para ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë,⁸⁵ rezulton se ky rast është përmbyllur në vitin 2023, pas 11 vitesh për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore.⁸⁶ Gjatë këtij harkut kohor prej 11 vitesh janë ndërmarrë këto veprime për trajtimin e këtij rasti:

Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, deri në përfundimin e shqyrtimit;⁸⁷

Dërgimi i çështjes për kompetencë tek ILD;⁸⁸

Dërgimi për kompetencë tek KLGJ për verifikimin e rënies së shkakut të pezullimit;⁸⁹

Vendimi i KLGJ për plotësimin e kushteve të rënies së shkaqeve të pezullimit;⁹⁰

Caktimi i relatorit dhe seancës dëgjimore nga ana e KLGJ-së;

Kërkesë nga ana e ILD-së për mbylljen e procedimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkeljeve.

Nga ky rast vlen të evidentohet se ILD ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar të rasteve analoge, duke vendosur për arkivimin e kërkesave ose mbylljen e procedimit. KShH vlerëson se kjo praktikë nuk është e drejtë, duke ju referuar rasteve për mbylljen e procedimeve disiplinore të mbartura nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (*Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë*). Sipas ILD-së kjo praktikë është e justifikuar për shkak të parashkrimit të shkaqeve të

⁸⁴Vendime KLGJ-se nr. 723, datë 07.12.2023, “Për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës”

⁸⁵Me shkresat nr. 4281/3 prot., datë 01.10.2012 dhe nr. 6127/17, datë 26.10.2012

⁸⁶Mbështetur në nenet 147,147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 117, 139 dhe 172 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

⁸⁷Me kërkesën e MD nr. 486 prot., datë 23.01.2013, si dhe me kërkesën nr. 486/1 prot, datë 10.07.2013

⁸⁸Me shkresën nr. 3696/1 prot., datë 30.06.2023

⁸⁹Me shkresën nr. 2170/1 prot., datë 28.07.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3696/2 prot., datë 31.07.2023,

⁹⁰Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 702 datë 30.11.2023 vendosi: “1. Shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 19.07.2013 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.

shkeljeve, të cilat kanë ndodhur në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit 8 gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.⁹¹

KShH e ka evidentuar këtë praktikë dhe në raporte të tjera dhe vlerëson se ankesat e administruara brenda afatit ligjor pranë ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të vijonin të trajtoheshin nga ILD, pasi bazuar në parimin e vazhdimësisë institucionale, tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve (*Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligjit Nr.115/2016*). Në vlerësimin e KShH-së, në respekt të parimit të vazhdimësisë së juridiksionit të institucioneve të reja të drejtësisë, është përgjegjësi e ILD dhe KLGJ për procedimin disiplinor të magistratëve edhe për zgjidhjen e çështjeve të mbartura, sipas nenit 117 të Ligjit Nr.115/2016. Rrjedhimisht, KShH i ka sugjeruar KLGJ të rishikojë nëpërmjet “Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave të arkivuara të ILD-së”, çdo praktikë të ILD për mbylljen e procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura, të cilat kanë qenë në listë pritje për shkak të reformimit të institucioneve.⁹²

9. Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të institucioneve ligjore ose dhe kryesisht të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ-së, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.⁹³

Gjetje: Gjatë vitit 2023, ILD rezulton të ketë trajtuar 2340 ankesa, nga të cilat 1268 janë ankesa të depozituara pranë ILD-së dhe 1072 janë ankesa të fondit “backlog” (*të mbartura para krijimit të ILD*). Pas shqyrtimit të ankesave, ILD ka miratuar 1631 vendime, nga të cilat:

1061 vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të 1616 ankesave;

552 vendime për arkivimin pas verifikimit të 707 ankesave;

16 vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit, të 17 ankesave;

2 vendime për hetim disiplinor të nisura me iniciativë nga ILD.

⁹¹Në kohën kur kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, për shkeljet disiplinore të kryera nga magistratët ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit 8 gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 34, pika 2, parashikonte se: “Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes”.

⁹²Vendim i KLGJ-së nr.717, datë 06.12.2023 për caktimin e relatorit dhe seancës dëgjimore për procedimin disiplinor të magistratit; Vendim i KLGJ-së nr. 702/2023, “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

⁹³Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

ILD ka parashtruar në kuadër të procesit konsultues të këtij raporti shpjegime të mëtjshme në lidhje me shkaqet e arkivimit të 552 rasteve, për të cilat:

Pretendimet e ngritura nuk përbëjnë shkelje disiplinore;

Pretendimet e ngritura përbëjnë veprime/mosveprime të cilat janë objekt i kontrollit i shkallëve më të larta të sistemit gjyqësor;

Pretendimet e ngritura janë për subjektet që nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencës së ILD-së⁹⁴;

Pretendimet e ngritura lidhen me magjistratë të shkarkuar nga vetting e për pasojë nuk ka më lëndë për shqyrtimin e pretendimeve;

Pretendimet e ngritura lidhen me magjistratë të dalë në pension apo të dorëhequr.

Gjatë vitit 2023, ILD ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, ku pesë procese janë për 5 gjyqtarë pranë KLGJ-së, dhe 1 proces është për 1 prokuror pranë KLP. Procedimet kanë të bëjnë me shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale,

Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin,

Veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale,

Për rastet kur gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Gjatë këtij viti, të gjitha kërkesat e paraqitura kanë qënë në fazë shqyrtimi nga ana e Këshillit. Sipas raportit për planin strategjik, shkak për ecurinë e ngadaltë të trajtimit të ankesave është mungesa e stafit prej 11 inspektorësh në këtë institucion. Në çdo rast, KShH vlerëson se krahas faktit se ky institucion aktualisht ushtron veprimtarinë me burime njerëzore të kufizuara, nga ana tjetër, ndjek një numër modest të procedurave që finalizohen me fillim hetimesh të masave disiplinore, përkatësisht 18 të tilla për vitin 2023. Edhe pse institucioni administron 2340 ankesa përfshirë dhe ato të mbartura nga vitet e kaluara, volumi i punës që mbulon ILD për 18 hetime disiplinore është larg pritshmërive, nëse krahasojmë përshembull volumin ose ngarkesën mesatare të gjyqtarëve përgjatë një viti e cila për vitin 2023 ka qënë 841 çështje për gjyqtar.

Nga verifikimet rezulton se ILD ka të integruar një program transparence që funksionon si për arritjen e disa objektivave që lidhen me transparencën dhe informimin e qytetarëve apo për aksesin

⁹⁴ Kancelar/sekretar gjyqësor/oficerë të policisë gjyqësore/avokatë/përmbaues/ekspertë etj

e tyre për të regjistruar kërkesë/ankesat e tyre si fizikisht, me telefon, me postë dhe nëpërmjet platformave online apo rrjeteve sociale. Të dhënat mbi kërkesat e tyre, qytetarët mund ti marrin përmes një regjistri të kërkesë/përgjigjeve që publikohet në faqen zyrtare të ILD-së. Qytetarët mund të marrin informacion në faqen zyrtare edhe përmes rubrikave si “pranohen ankesat?”, apo pyetje mbi procesin e ankimimit. Për më tepër, ILD ka kryer rreth 25 herë anketime të integruara në programin e transparencës dhe anketimin online mbi veprimtarinë e ILD-së për vitin 2023.

Pavarësisht sa më sipër, KShH vlerëson faqja zyrtare e ILD-së nuk siguron akses me të dhëna statistikore të mjaftueshme mbi veprimtarinë e tij, sa i përket hetimeve disiplinore, të cilat mund të përmirësojnë transparencën e institucionit. Të vetmet dokumenta që ofrojnë informacion janë raportet vjetore të punës dhe buletinët mujorë, të cilët nuk sigurojnë të dhëna të mjaftueshme statistikore për këtë qëllim. Në faqen zyrtare të ILD-së për vitin 2023 janë publikuar raportet e punës vjetore dhe plani strategjik për vitin 2023-2025 dhe janë bërë publike 8 akte zyrtare. Një hap pozitiv për vitin 2023, është se ILD ka miratuar metodologjinë për regjistrimin e statistikave, analizimin dhe raportimin e informacionit statistikor për ankesat/çështjet e adresuara tek ILD. Ky hap mundëson klasifikimin e informacionit sipas përdorimit, si informacion që duhet të hidhet në sistem për secilën çështje që hetohet,⁹⁵ informacioni që pasqyrohet në dosjen hetimore që i dërgohet Këshillit, informacioni i aksesueshëm vetëm për magjistratin që hetohet, informacioni që mund të aksesohet nga publiku.

Në funksion të transparencës për publikun, KShH përshëndet përpjekjet dhe masat e marra në këtë drejtim si dhe nxit ILD-në të krijojë sa më shpejt një regjister që azhurnohet në mënyrë periodike në faqen e tij zyrtare, me të dhëna në lidhje me ecurinë e trajtimit të ankesave dhe hetimeve administrative disiplinore, që nga data e marrjes dhe deri tek dalja e KLGJ me vendim (*nëse ka*). Krijimi i këtij regjistri përmirëson transparencën, shërben si bazë të dhënash për çdo studiues, median, publikun si dhe i shërben transparencës ndaj magjistratit që hetohet.⁹⁶

Gjithashtu për shkak të procedurave të ndërlidhura ndër-institucionale vlerësohet se nevojitet një koordinim sa më efikas në mes institucioneve të ILD-së me KLGJ-në për menaxhimin e integruar të të dhënave mbi procedimet disiplinore.⁹⁷ Në lidhje me këtë, ILD ka sqaruar se ka detyrim ligjor të njoftojë palët në proces, sipas çdo vendimmarrje në kompetencë të tij, në kuadër të shqyrtimit

⁹⁵Kështu, për çdo rast duhet të pasqyrohet në sistem: a) gjenealogjia dhe adresa e magjistratit; b) të dhënat e ankuesit nëse hetimi ka filluar mbi bazën e ankesës, c) objekti i hetimit, ç) ecuria e hetimit, d) të dhëna nëse hetimi është arkivuar, mbyllur apo është dërguar për procedim disiplinor në Këshill, dh) vendimmarrja e Këshillit, si dhe e) informacione të tjera

⁹⁶Urdhër i ILD-së nr. 107, datë 06.10.2023, "Për miratimin e metodologjisë për analizën dhe raportimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë"; Urdhër nr. 106, datë 05.10.2023, "Për miratimin e formularëve statistikorë dhe metodologjinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet kryesisht drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë"; Urdhër nr. 105, datë 05.10.2023, "Për regjistrimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë, në formularin e platformës office 365 - aplikacioni list, për vitin 2023"; Urdhër nr. 101, datë 02.10.2023, "Për miratimin e formularit të ankesës, të ripunuar dhe udhëzimit për plotësimin e tij"; Urdhër nr. 100, datë 02.10.2023, "Për miratimin e formularit për regjistrimin dhe grumbullimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar zyrës së ild-së në bazën e të dhënave nëpërmjet platformës office 365 - aplikacioni list; Urdhër nr. 94, datë 12.09.2023, "Për marrjen e informacionit periodik nga kryetaret e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorisë lidhur me veprimtarinë gjyqësore dhe veprimtarinë e prokurorisë"

⁹⁷Për menaxhimin e disa aspekteve procedurale që kanë të bëjnë me shkeljet disiplinore (sipas kategorive), vërejtjeve, pezullimeve, shkarkimeve duke respektuar kriteret për masat disiplinore sipas kategorive dhe duke respektuar në maksimum kohëzgjatjen e procedurave sipas kërkesave të procesit të rregullt ligjor (nenet 100-116 të ligjit për statusin)

të ankesave, hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor, duke garantuar kështu parimet e një procesi të rregullt. Ecuria e hetimit disiplinor, ka karakter konfidencial dhe ushtrohet në mënyrë të përshtatshme, të balancuar dhe proporcionale duke garantuar mbrojtjen e integritetit dhe figurës së magjistratit nga akuzat e pabaza. Megjithatë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, krijimi i një regjistri do të mbahet parasys, në të ardhmen.

10. Rekomandime

Në funksion të garantimit të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së sistemit Gjyqësor, KShH vlerëson se KLGJ dhe ILD me burimet njerëzore që kanë në dispozicion duhet t'i përgjigjen nevojave të sistemit në mënyrë më eficiente dhe me afate të arsyeshme, në përputhje me kompetencat që secili prej këtyre institucioneve gëzon sipas Kushtetutës dhe Legjislacionit në fuqi.

KShH vlerëson se procedurat për emërimin, ngritjen në detyrë, dhe lëvizjen paralele kanë një impakt të rëndësishëm në drejtim të funksionalitetit të sistemit gjyqësor në tërësi, sa i takon garantimit të standarteve të efikasitetit dhe cilësisë, por mbi të gjitha impaktit thelbësor për përforcimin e statusit të gjyqtarit. Nisur nga fakti se procedura të tilla nuk kanë afate ligjore të përcaktuara në aktet ligjore, KShH vlerëson se një menaxhim efikas i tyre është kusht për të garantuar standardet e procesit të rregullt ligjor në zbatim të Kushtetutës (*Neni 42*) dhe KEDNJ-së (*Neni 6*). Këto procese, sikurse është pranuar nga institucioni i KLGJ-së, janë komplekse pasi ndërlidhin veprimtarinë e dy komisioneve brenda Këshillit, por dhe përfshijnë institucione të tjera që bashkëveprojnë për verifikime që ndjekin qëllime të ndryshme (pasuria, figura, vlerësimi etiko-profesional i gjyqtarit etj). Nisur nga nevoja për procedura që garantojnë kohëzgjatje sa më normale për këtë kategori specifike vendimarrjesh, KShH inkurajon krijimin e mekanizmave koordinues për bashkërendimin dhe harmonizimin e hapave administrative të ndërlidhura në këto procedura. Në mënyrë të veçantë, nevojitet rregullimi i mëtejshëm i afateve për procedurat që janë të ndara në disa faza, në mënyrë që të lehtësohet menaxhimi dhe parashikueshmëria e tyre.

KShH vlerëson se është e nevojshme të konsultohet nevoja për ndryshime ligjore në nenin 32 dhe në nenin 35 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, me synim shmangien e përsëritjes dy herë të procedurave të verifikimit të figurës dhe pasurisë së kandidatëve të diplomuar për magjistratë brenda një harku kohor prej 3 vitesh, një herë për pranimin në programin e formimit dhe një herë tjetër pas diplomimit si magjistrat dhe emërimit.

KShH vlerëson se në kuadër të garancive për standartin e ligjshmërisë dhe transparencës sipas nenit 6 të KEDNJ-së, vendimet e KLGJ-së për emërimin, ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele kërkojnë një përmbajtje më konçize, të qartë dhe të kuptueshme për publikun, duke përmirësuar pjesën arsyetuese që nxjerr në pah meritokracinë e procesit. Në funksion të parimit të besimit të publikut në procesin e karrierës së gjyqësorit, vlen të pasqyrohen në këto vendime, shkaqet e tërheqjes së kandidatëve nga pozicioni, kur ka tërheqje të tilla.

KShH vlerëson se vendimet e transferimit të magjistratëve kërkojnë një arsyetim të detajuar, nisur nga kërkesat rigoroze sipas nenit 44 dhe 42 të Ligjit “Për statusin”. Pavarësisht, se vendimmarrjet e KLGJ-së për këtë qëllim shoqërohen me relacionin përkatës, ku arsyetohen në mënyrë të detajuar se si përmbushen kriteret ligjore nga ana e kandidatëve për transferim, KShH rithekson se vendimet e KLGJ-së duhet të reflektojnë në mënyrë të sintetizuar se si përmbushen kriteret ligjore nga ana e gjyqtarëve kandidatë. Më konkretisht, për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit, nevojitet të argumentohet në vendim sa ka qënë numri i kërkesave për pozicionet e shpallura për transferim, si janë përmbushur kriteret nga secili kandidat që ka aplikuar, cili është efekti që krijon transferimi tek gjykatat e gjyqtarëve që transferohen, cila është dobia e gjykatës pritëse etj.

KShH vlerëson se në kuadër të garantimit të parimit të ligjshmërisë të procedurës së transferimit me zgjedhje, duhet shmangur vendimmarrja brenda të njejtës ditë me shpalljen e vendimit, pasi në aspektin cilësor i jep procesit një karakter ngushtësisht formal dhe të paracaktuar. Po ashtu vlerësohet se KLGJ duhet të arsyetojë në vendimet për transferimin me zgjedhje të gjyqtarëve, se si janë përzgjedhur gjykatat që i propozohen gjyqtarëve për tu transferuar.

KShH vlerëson se në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe parimit të vazhdimësisë institucionale, KLGJ duhet të evitojë një precedentin e krijuar nga ILD, për mbylljen e procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura, të iniciuara nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (KLD dhe MD). Në këtë kuptim, i sugjerohet KLGJ-së që me nismën e vetë të shqyrtojë dhe vendosë anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve të ILD-së sipas nenit 99 të Ligjit 115/96 “Për qeverisjen e institucioneve të qverisjes së drejtësisë”, për mbylljen e procedimeve disiplinore sipas kërkesave që kanë qënë në listë pritje për shkak të reformimit të institucioneve.

KShH në kuadër të garantimit të transparencës ndaj publikut sipas nenit 2 të Ligjit 115/96 “Për organet e qeverisjes së institucioneve të drejtësisë” dhe garancive të procesit të rregullt ligjor sipas standarteve të nenit 6 të KEDNJ-së, i rekomandon KLGJ-së krijimin e një rubrikë të dedikuar vetëm për procedimet disiplinore në faqen zyrtare të saj, ku të identifikohen lehtësisht seancat dëgjimore të mbledhjeve plenare të Këshillit me procesverbalet e mbledhjeve plenare të cilat kanë pasur në axhendë diskutimi procedime disiplinore të magjistratëve.

KShH në kuadër të garantimit të transparencës ndaj publikut sipas nenit 2 të Ligjit 115/96 “Për organet e qeverisjes së institucioneve të drejtësisë”, inkurajon ILD-në për krijimin e regjistrit mbi ecurinë e trajtimit të kërkesë/ankesave për procedimin disiplinor të magjistratëve në faqen zyrtare të ILD-së, në shërbim të gjyqtarit që hetohet, KLGJ-së dhe publikut të gjerë për të marrë të dhëna lidhur me ecurinë e procesit hetimor.⁹⁸

⁹⁸Më konkretisht, ILD ka miratuar urdhërat si më poshtë në funksion të ngritjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve. Urdhër nr. 107, datë 06.10.2023, “për miratimin e metodologjisë për analizën dhe raportimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë” Urdhër nr. 106, datë 05.10.2023, “për miratimin e formularëve statistikorë dhe metodologjinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet kryesisht drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë” Urdhër nr. 105, datë

KShH vlerëson se menaxhimi i kohëzgjatjes sa më të arsyeshme të mbledhjeve plenare për procedimet disiplinore kërkon një marrëveshje institucionale mes KLGJ-së dhe ILD-së, për mënyrën se si mund të përmirësohet praktika administrative për situata që mund të sjellin zvarritje të procesit e për rrjedhojë cënim të nenit 6 të KEDNJ-së.

Aneks: Komentet/sugjerimet që evidentohen të ndara nga raporti

A. Në lidhje me gjetjet për veprimtarinë e KLGJ

1. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Vendimet për procedurat për transferimet *me pëlqim të dedikuar*, rezultojnë se janë marrë brenda të njëjtës ditë me shpalljen e procedurës së transferimit, çfarë krijon mangësira në aspektin cilësor, për shkak se i jep procesit një karakter ngushtësisht formal dhe të paracaktuar në kuptim të rezultatit të tij.

Komente të KLGJ-së:

KLGJ sjell në vëmendje se referuar nenit 46 të Ligjit për Statusin, në transferimet e përkohshme Këshilli u drejtohet gjyqtarëve të gjykatave me ngarkesën më të ulët të japin pëlqimin për transferim për një periudhë të caktuar. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin gjyqtari. Më tej, Këshilli i drejtohet kandidatit fitues që përmbush kriteret ligjore lidhur me shprehjen e interesit.

1.2. Komente të KShH-së:

Shpallja e procedurës së transferimit kërkon respektimin e një sërë hapave të ndërmjetëm proceduriale, deri në marrjen e vendimit për transferimin e gjyqtarit. Në këtë drejtim, kërkohet të garantohet standarti i ligjshmërisë dhe i transparencës së procedurave, sa i takon reflektimit të duhur në aktet ligjore të mënyrës se si janë përmbushur kriteret për transferimin e gjyqtarit. Shmangia e këtyre procedurave mund të krijojë shkaqe për cënimin e sigurisë juridike, pasi çojnë në një vendimmarrje formalisht të paracaktuara.

2. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Në vendimet për procedurat për transferimet *me pëlqim të dedikuar* është e paqartë se mbi ç'bazë kriteresh është udhëhequr KLGJ për të përzgjedhur gjykatat e rretheve gjyqësore për t'ia propozuar gjyqtarëve që kanë një pozicion të përhershëm në gjykatën që shkrihet për shkak të zbatimit të hartës së re gjyqësore.

05.10.2023, "për regjistrimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë, në formularin e platformës office 365 - aplikacioni list, për vitin 2023"Urdhër nr. 101, datë 02.10.2023, "për miratimin e formularit të ankesës, të ripunuar dhe udhëzimit për plotësimin e tij"Urdhër nr. 100, datë 02.10.2023, "për miratimin e formularit për regjistrimin dhe grumbullimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar zyrës së ild-së në bazën e të dhënave nëpërmjet platformës office 365 - aplikacioni listUrdhër nr. 94, datë 12.09.2023, "për marrjen e informacionit periodik nga kryetaret e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë gjyqësore dhe veprimtarinë e prokurorive"

Komente të KLGJ-së:

Sa i përket kësaj pike ajo çfarë vlen të theksojmë është se, KLGJ, në raste te mungesës së magistratëve në skemën e delegimit, vendos në lidhje me transferimin e përkohshëm dhe për procedurën e transferimeve ka parasysh gjykatat me vakanca më të larta, numrin më të madh të çështjeve në pritje për shqyrtim, gjykata në të cilat ka mungesë trupash gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve të natyrës penale, civile por gjithmonë duke patur parasysh ngarkesën e gjykatës në të cilin ai ushtron funksionin. Ky parashikim ligjor gjen mbështetje në nenin 46 të Ligjit për Statusin. Këshilli ka vendosur përseritjen e transferimit kur ka qenë e nevojshme, referuar ngarkesës së gjykatave në të cilin ato ishin transferuar. Procedura e transferimit gjen mbështetje në dispozitat ligjore të Ligjit për Statusin, konkretisht nenet 42,43,44-46 dhe në Vendimin Nr. 23, datë 7.02.2019 të KLGJ për “Miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, në të cilat mbështetet vendimmarrja e KZHK duke respektuar në mënyre rigorozë kërkesat e ligjit sa i përket kriterëve dhe parimeve për zbatim. Kjo lloj procedure e plotësimit të vakancave ka qenë si rezultat i zbatimit të hartës gjyqësore, pasi duke u suprimuar pozicionet në të cilin ata ishin më përpara dhe riskutrukturimi i disa gjykatave në zbatim të kësaj harte ka bërë të nevojshme plotësimin e vakancave të krijuara.

Vlen për t’u theksuar se këto procedura janë kryer me qëllim për të paraprirë procesin e lëvizjes paralele, si edhe për të përmirësuar situatën në këto Gjykata. Këshilli ka vlerësuar se në funksion të lëvizjes paralele dhe për të krijuar në një kohë sa më shpejt që të jetë e mundur lirimin e pozicioneve të kandidatëve që konkurrojnë në këto procedura, për gjykatat e marra në analizë të përdoren procedurat e transferimit të përkohshëm të parashikuar nga neni 46 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), si edhe aktin nënligjor të miratuar në zbatim të tij, (Rregullore e Transferimit të Përkohshëm), si një nga instrumentet më të shpejtë në kohë, që mund të stabilizojë funksionalitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. **Natyrisht qëllimi i kryerjes së këtyre procedurave të transferimit të përkohshëm do të jetë që nëpërmjet kombinimit të kësaj skeme me pritshmërinë e skemës së lëvizjeve paralele ku kandidatët konkurrojnë të vetëm, të mund të krijohen pozicionet e reja për magistratët e rinj. Në vlerësim të Këshillit, aplikimi sa më shpejt i këtij kombinimi krijon vendet e përhershme për caktimin e gjyqtareve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.** Natyrisht skema e përdorur respekton qëllimin e përcaktuar nga neni 42 i Ligjit Për Statusin që të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit dhe zhvillimit të karrierës të magistratit.

Komente të KShH-së:

KShH rithekson se këto procedura janë formalisht të paracaktuara, duke çuar në anashkalimin e disa aspekteve që kërkojnë një pasqyrim më transparent në aktet e transferimit të gjyqtarëve. Kështu, siç është evidentuar nga analiza e këtyre akteve, në vendimet për transferimin nuk janë

reflektuar mjaftueshëm mbi ç'bazë kriteresh është bërë përzgjedhja e gjykatës respektive që i është propozuar gjyqtarit që transferohet. Ky aspekt, është i rëndësishëm në drejtim të një vendimarrje që garanton interesin më të lartë të gjyqtarit për fuqizimin e statusit të tij në harmoni me parimin e proporcionalitetit.

3. Konstatime në draft raportin e KShH-së

KShH vlerëson se referuar të dhënave për numrin e ulët të procedimeve disiplinore për gjyqtarët (*vetëm 5 të tilla*) rezulton se nuk është ruajtur një qasje proporcionale sa i takon përgjegjshmërisë që materializohet nëpërmjet procedimeve disiplinore, të cilat varen nga kërkesat e bëra prej ILD-së dhe konkludohen nga Këshilli. Kjo përgjegjësi e përbashkët ndërinstitucionale duhet parë në respektim të parimit të qeverisjes së mirë të sistemit të drejtësisë, sipas nenit 2 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", që parashikon se sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efijencës.

Edhe pse plotësimi i vakancave nëpër gjykata ka qënë objektiv kryesor për KLGJ-në nëpërmjet promovimit të gjyqtarëve përmes lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo komandimeve, rezulton se procedimet disiplinore nuk kanë pasur të njëjtin trend. Kështu figuron se ILD dhe KLGJ nuk kanë pasur mjaftueshëm produktivitet në drejtim të materializimit të përgjegjësisë së përbashkët institucionale për garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve, pasi numri total i ankesave për procedurat disiplinore që administrohen nga ILD nuk është proporcional në raport me procedimet disiplinore që konkludohen me kërkesë për inicim tek KLGJ nga ky institucion.

3.1. Komentë të KLGJ-së:

Vlerësojmë se nuk ka arsye të maten numerikisht procedimet disiplinore të cilat zhvillohen në Këshill në bazë të kërkesave të ILD. Fakti që janë përcjellë 5 kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor do të thotë se ILD pas zhvillimit të hetimit disiplinor nuk ka konstatuar shkeljet të rënda për të cilat mund të fillohet procedim disiplinor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor për vitin 2023 ka kaluar për shqyrtim 4 procedura disiplinore të filluara rishtazi gjatë këtij viti dhe janë vënë në lëvizje dy procedura të mbartura ngavitet e mëparshme. KLGJ ka proceduar me dhënien e vendimit jo përfundimtar, konkretisht: me pezullimin e procedimeve disiplinore lidhur me 2 procedura të filluara për magjistratët B.M., R.A. dhe K.Dh., deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përmes të cilët është disponuar dhënia e masës disiplinore "Shkarkimin nga detyra"; me pezullimin e procedimeve disiplinore, për një periudhë 1-vjeçare, lidhur me 3 procedurat disiplinore të filluar në ngarkim të magjistratit S.U, në kushtet kur më herët për këtë magjistrat, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të pa mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Rrethanë kjo që përbën shkak për pezullimin e shqyrtimit të këtyre procedurave disiplinore të filluara nga ILD. Sa i përket dy procedurave disiplinore të pezulluara me pare ne

kushtet e renies se shkakut te pezullimit eshte vendosur shfuqzimi i vendimeve te pezullimit dhe trajtimi i ceshtjeve në themel.

Procedimet e sjella nga ILD, jane pezulluar ne disa raste per te pritur vendimmarrjet e organeve te vettingut, prandaj nuk mund te kete nje qasje peoporcionalë. Fakti nëse kërkesat do të përcillen pranë KLGJ-së është në vlerësim të ILD pasi të ketë kryer hetimin disiplinor. Nëse rezultatet e hetimit çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, vetëm atëherë fillon procedimi disiplinor pranë Këshillit, duke qene se organet e Vetingut disponojne me masa disiplinore shkarkim nga detyra ose kthim ne shkolle dhe pritet përfundimi i procedures se lidhur.

3.2.Komente të KShH-së:

Konstatimi i KShH-se lidhet me pamjaftueshmërinë e materializimit të përgjegjësisë institucionale fillimisht të ILD-së, nisur nga numri i lartë i ankesave të regjistruara kundrejt magjistratëve, mbi 2340 të tilla në vitin 2023. Nga këto ankesa, vetëm 1631 janë konkluduar me vendime, ndër të cilat ka pasur vetëm 16 vendime nga ana e ILD-së për fillim të hetimit disiplinor. Nga këto 16 vendime për hetimin e magjistratëve, siç rezulton janë kërkuar në KLGJ vetëm 6 procedime disiplinore për 5 gjyqtarë dhe 1 prokuror. Kjo e dhënë statistikore ndihmon institucionet përgjegjëse për të kuptuar se si ka evoluar ecuria e ndjekjes se ankesave që nga momenti i tyre i regjistrimit në ILD dhe deri në marrjen me vendim për procedim disiplinor ndaj magjistratëve në KLGJ. Kontrasti i theksuar në mes numrit të lartë të ankesave dhe numrit tepër të papërfillshëm të hetimeve dhe vendimeve për procedim disiplinor, vë në pah hendekun në mes nevojës së lartë për llogaridhënie të magjistratëve dhe numrit tepër të ulët të procedimeve disiplinore të eventualizuara me një vendim konkret. Për KShH llogaridhënia e sistemit nuk nënkupton shkarimin e gjyqtarëve nga detyra, por aplikim edhe të masave më të buta disiplinore që korrektojnë sjelljen e magjistratit kur ajo është në cenim të detyrave të tij/saj. Vlen të theksohet se një statistikë e tillë ka qënë thuajse e njëjtë në periudhën e funksionimit të institucioneve të vjetra të drejtësisë, ndaj në parim nuk justifikon as reformimin e thellë institucional në sistemin e drejtësisë, që në thelb ka pasur objektivin e tij kryesor, garantimin e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së magjistratëve.

4. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Në veçanti, aktet për procedurat disiplinore aksesohen me vështirësi përmes publikimit të mbledhjeve plenare, të cilat nuk ndjekin një renditje sipas objektit të axhendës të dedikuar specifikisht për procedurat disiplinore por publikohen sipas datave pa pasur nje identifikim konkret të tyre. Kjo situatë nuk garanton standartin e transparencës, pasi për këto procedura vështirësohet konsolidimi i praktikës administrative si dhe anashkalohen parregullsi të procesit në drejtim të kohëzgjatjes së arsyeshme, të cilat mund të sjellin cënimin e nenit 6 të KEDNJ-së.

4.1. Komente të KLGJ-së:

Vlerësojmë se publikimi në faqen zyrtare të KLGJ bëhet sipas nenit 69 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, përmes dokumentimit në procesverbalin e mbledhjes si dhe regjistrimit audio dhe lehtësisht gjendet përmes njoftimit të mbledhjes përkatëse.

4.2. Komentë të KShH-së:

Në lidhje me këtë konstatim, KShH përshëndet faktin se ka një vullnet nga ana e institucionit të KLGJ-së për të përmirësuar në të ardhmen publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare në një rubrikë të veçantë, vetëm për ato mbledhje ku janë shqyrtuar procedime disiplinore të magistratëve. Qëllimi i krijimit të kësaj rubrike në faqen zyrtare të KLGJ-së, është të rendisë në mënyrë kronologjike të gjitha mbledhjet plenare të KLGJ sipas seancave për secilin procedim disiplinor, në mënyrë që të evidentohen qartë ecuria e procedimit nga seanca e parë deri tek dalja e KLGJ-së me vendim përfundimtar (përfshirë dhe vendimarrjet për shkak të ushtrimit të së drejtës së magistratit për tu ankuar). Kjo nismë është e rëndësishme pasi përmirëson aksesin në lidhje me vendimarrjen për procedimet disiplinore, por gjithashtu garanton parashikueshmërinë e kohëzgjatjes së procedimeve të tilla sipas standarteve të transparencës dhe procesit të rregullt ligjor.

5. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Nga analiza e akteve rezulton se vendimet e KLGJ-së për komandimet janë të arsyetuara dhe reflektojnë transparencën e procedurave të ndjekura.⁹⁹ Skema e komandimit për vitin 2023 ka ndihmuar kryesisht Gjykatën e Lartë për plotësimin e vakancave me ndihmës magistrat, si dhe Gjykatën Kushtetuese për plotësimin e numrave me ndihmësgjyqtarë. Në kushtet kur sistemi gjyqësor po përballë me vakanca në rradhët e gjyqtarëve, KShH vijon të vlerësojë si problematike komandimin e gjyqtarëve jashtë sistemit gjyqësor.¹⁰⁰

5.1. Komentë të KLGJ-së:

KLGJ, në çdo rast të komandimeve të magistratëve është kujdesur që të mbajë në vëmendje ruajtjen e funksionalitetit të gjykatave nga vijnë gjyqtarët e komanduar. Kryesisht magistratët e komanduar vijnë nga gjykata me organikë të plotësuar. Komandimet në institucionet e drejtësisë janë në një numër të ulët krahasimisht me gjyqtarët që ushtrojnë detyrën brenda sistemit (Pranë ILD, MD, SHM, GJEDNJ), dhe kontributi i tyre në funksion të insitucioneve të drejtësisë është një vlerë e shtuar. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, e ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe në mënyrë të veçantë, ka parashikuar procedura të veçanta kur konstaton

⁹⁹Vendim nr.226, datë 08.05.2023 për përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagogë e brendshme pranë Shkollë e Magistraturës; Vendim nr.730, datë 07.12.2023, Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese

¹⁰⁰<https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2023/02/Dritehijet-dhe-Efektet-e-Hartes-se-Re-Gjyqesore.pdf>

pozicione të lira, pas çdo kontrolli tre mujor të kryer me qëllim konstatimin e tyre. Për më tepër në nenin 89 pika b, Këshilli ka detyrimin të monitorojë ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të tyre në mënyrë që parimi “*gjykimi brenda një afati të arsyeshëm*” të mos konvertohet në “*drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar*”.

5.2. Komente të KShH-së:

Në vitin 2023, sistemi gjyqësor ka funksionuar me një numër prej 247 gjyqtarësh nga 408 gjyqtarë të miratuar në total në organikë. Në një situatë të tillë *sui generis*, KShH nuk rekomandon komandimin e gjyqtarëve në institucionet e tjera të drejtësisë, nisur nga nevoja tepër e lartë që kanë gjykatat për plotësimin e trupave gjyqësore, për shkak të mbingarkesës së krijuar, qoftë nga zbatimi i hartës së re gjyqësore, po ashtu dhe nga vakancat e krijuara për stafin e gjyqtarëve si rezultat i procesit të vetingut. Prania e gjyqtarëve në sistem është një nevojë që garanton aksesin në drejtësi dhe gjykimin e çështjeve në kohë të arsyeshme, si elementë të rëndësishëm të procesit të rregullt gjyqësor.

6. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Vlen të përmenden në këtë analizë edhe konstatimet e mëparshme të KShH në raportin e tij të parë për hartën e re gjyqësore, sipas të cilit aktet administrative individuale të KLGJ-së në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, **të shoqëruara me arsyetimin përkatës** sipas nenit 98, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së drejtësisë*”.

6.1. Komente të KLGJ-së:

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, e ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin etj dhe ka parashikuar procedura të veçanta kur konstaton pozicione të lira, **pas çdo kontrolli tre mujor të kryer me qëllim konstatimin e tyre**, që çdo tre muaj të hapë procedurat për transferimet nëpërmjet lëvizjeve paralele. Kjo për shkak të marrjes së masave për administrimin siç duhet të lëvizjeve të gjyqtarëve drejt gjykatave që konsiderohen gjykata karriere dhe për të hapur pozicionet për magjistratët që pritet të diplomohen. Ky proces i nënshtrohet procedurave të verifikimit të përmbushjes së kriterëve formale, pasurisë dhe figurës si edhe vlerësimit etik dhe profesional.

6.2. Komente të KShH-së:

KShH vlerëson se vendimet e transferimit të magjistratëve kërkojnë një arsyetim të detajuar, nisur nga kërkesat rigoroze sipas nenit 44 dhe 42 të Ligjit “Për statusin”. Pavarësisht, se vendimmarrjet e KLGJ-së për këtë qëllim shoqërohen me relacionin përkatës, KShH rithekson se vendimet e KLGJ-së duhet të reflektojnë në mënyrë të sintetizuar, se si përmbushen kriteret ligjore nga ana e

kandidatëve për transferim. Më konkretisht, për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit, nevojitet të argumentohet në vendim sa ka qënë numri i kërkesave për pozicionet e shpallura për transferim, si janë përmbushur kriteret nga secili kandidat që ka aplikuar, cili është efekti që krijon transferimi tek gjykatat e gjyqtarëve që transferohen, cila është dobia e gjykatës pritëse, etj. Ndërsa për transferimet e gjyqtarëve me *pëlqim të dedikuar*, vihet në dukje nevoja për arsyetimin e vendimet për shpalljen e procedurave, të cilat duhet të arsyetojnë nevojën e gjykatave pritëse për transferimin e magjistratëve sipas treguesve të efikasitetit dhe produktivitetit. Gjithashtu, vendimi për transferimin e gjyqtarit duhet të pasqyrojë kriteret për selektimin e gjykatës që i propozohet gjyqtarit për tu transferuar.

7. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Nga verifikimi i akteve për caktimet, të përzgjedhura për analizën e këtij raporti,¹⁰¹ rezulton se pavarësisht referimit formal të kriterëve ligjorë¹⁰², në këto akte nuk jepen të dhëna mbi mënyrën se si respektohen kriteret e afërsisë gjeografike, ngarkesa e gjyqtarëve që caktohen, nëse gjyqtari është caktuar në më shumë se një gjykatë, apo për të gjykuar më shumë se një çështje në të njëjtën gjykatë. Kjo mungesë në arsyetim vazhdon të jetë një problem dhe në aktet e KLGJ-së për këtë kategori të vendimeve, të cilat duhet të ofrojnë standartin e ligjshmërisë sipas ligjit dhe Kushtetutës.

7.1. Komente të KLGJ-së:

Gjetjet si në paragrafin e mësipërm të cilat janë, relacioni i propozuar nga Komisioni përkatës dhe i miratuar nga Këshilli ka analizuar në mënyrë ezauruese gjithë kriteret ligjorë për shpalljen e gjykatave në nevojë, deri në përmbylljen e procedurës me transferimin e gjyqtarëve përkatës.

7.2. Komente të KShH-së:

KShH vlerëson se kërkesat ligjore për marrjen e vendimeve për caktimin e gjyqtarëve janë të përshkallëzuara në rritje, krahasuar me kërkesat ligjore për vendimmarrjen për transferimin e gjyqtarëve. Kjo pasi caktimi mund të përdoret si skemë vetëm kur transferimi i përkohshëm dhe delegimi nuk kanë qënë të mjaftueshëm për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykatat me numër të lartë çështjesh. Prandaj, pavarësisht, se vendimmarrjet e KLGJ-së për këtë qëllim shoqërohen me relacionin përkatës, ku arsyetohen në mënyrë të detajuar se si përmbushen kriteret ligjore nga ana e kandidatëve për caktimin në çështje të veçanta në një gjykatë tjetër, KShH rithekson se vendimet e KLGJ-së duhet të reflektojnë në mënyrë të sintetizuar se si përmbushen kriteret ligjore

¹⁰¹ Vendim nr. 662, datë 02.11.2023 për caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit; Vendim nr. 524, datë 05.10.2023, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi caktimi në gjykatën e rrethit Lezhë, Berat, dhe Gjirokastrë; 101 Vendim nr. 484, datë 13.09.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 471, datë 26.07.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme; Vendim nr. 469, datë 25.07.2023 për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

¹⁰² Vendim Nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit mbi rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”

për caktimin e tyre. Ky arsyetim është i rëndësishëm, edhe për nga efekti që krijon kjo skemë në drejtim të karrierës dhe statusit të gjyqtarit, në respektim të nevojës për garantimin e autonomisë dhe pavarësisë së gjyqtarëve.

8. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Në fazën e dytë për lëvizjet paralele merret vendimi për renditjen e kandidatëve, e cila duhet të marrë për bazë cilësinë e ruajtjes së vendimeve për secilin kandidat. Për rastet kur kandidatët kanë aplikuar për më shumë se një pozicion, është relatori i caktuar për pozicionin më të ulët, që merr përsipër procesin për të kaluar në fazën e 3-të të vendimarrjes për caktimin e kandidatit për lëvizje paralele. Nga aktet e selektuara rezulton se tërësia e procedurave të tilla varion nga 6 muaj për kandidatët që nuk kanë aplikuar për pozicion tjetër deri në 10 muaj për ato që kanë aplikuar për disa pozicione. Në dijeni të faktit se për vitin 2023 ka pasur aplikime për 25 pozicione të lira, nga të cilat ka pasur 15 tërheqje nga kandidimi për lëvizje paralele nga 40 kandidatët që kanë aplikuar, një situatë e tillë krijon premisa që këto procedura të komplikohen dhe të ecin më avash.

8.1. Komente të KLGJ-së:

Nuk qëndron konstatimi se tërheqjet nga kandidimi krijojnë vonesa në procedurën e lëvizjes paralele pasi nga praktika e deritanishme nuk rezultojnë që tërheqjet nga kandidimi të kenë shkaktuar vonesa. Vendimi nr. 320 date 17.09.2020 i KLGJ-se “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ka për qëllim përcaktimin e rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8.2. Komente të KShH-së:

Në lidhje me këtë, KShH evidenton se në rastin e procedurave për lëvizje paralele, për të cilat rregullimet ligjore nuk parashikojnë afate, nuk bëhet fjalë për vonesa, por thjesht evidentohet tërheqja e kandidatëve nga gara, si një faktor që ngadalëson procedurat. Për shëmbull sipas konstatimit të KLGJ-së, i njëjti faktor ka ndikuar në zvarritjet e procedurave të emërimeve të gjyqtarëve nëpërmjet ngritjes në detyrë. Në të njëjtën linjë, vlerësohet se dhe për procedurat për lëvizje paralele, se mund të krijohen mekanizma që synojnë harmonizimin e tre fazave të ndërrvarura të procedurave administrative, për të menaxhuar mbarëvajtjen tërësore të procesit për lëvizjen paralele, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur shkaqet që ngadalësojnë procesin.

9. Konstatime në draft raportin e KShH-së

Si rregull, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë procedurat për verifikimin e kriterëve ligjore duhet të fillojnë jo më vonë se 7 ditë nga afati i kandidimit,¹⁰³ i cili shpallet jo më vonë se 2 javë nga data e publikimit të vendimit për hapjen e pozicioneve të lira. Ndërsa në gjykatat e tjera ky

¹⁰³Vendim i KLGJ-së nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë” (azhormuar me vendimin nr. 528, datë 10.11.2021); Vendim i KLGJ-së nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”

afat për fillimin e verifikimit të kriterëve ligjorë për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve nuk gjen rregullim në vendimin e KLGJ-së nr.70, datë 07.02.2020, “*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*”, çfarë krijon premisë për mungesë të standardit të ligjshmërisë dhe pasigurisë juridike, sipas kërkesave për procesin e rregullt ligjor në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane (KEDNJ-së). KShH vlerëson se kjo tejzgjatje e fillimit të verifikimit të kriterëve ligjorë për pozicionet e hapura duhet të analizohet me kujdesin e duhur, në mënyrë që të evitohet në të ardhmen

9.1. Komente të KLGJ-së:

Në lidhje me këtë gjetje duhet të theksojmë se procedura e verifikimit gjen mbështetje ligjore në ligjin për statusin dhe vendimet e KLGJ për miratimin e rregullave që ndiqen në lidhje me procedurat për të cilat ligji parashikon afate në kryerjen e veprimeve po ashtu afate për ankimet në gjykatë në lidhje me vendimarrjet e KLGJ-së. Të gjitha këto në tërësi kontribuojnë në kohëzgjatjen e kësaj procedure, e cila nuk varet nga Këshilli dhe është e pashmangshme pasi është në funksion të një procesi të rregullt ligjor dhe transparent në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane (KEDNJ-së). Vetëm në 1 (një) rast procesi i verifikimit filloi me 9 (nëntë) muaj vonesë, për pozicione të cilat afati i aplikimit përfundoi në maj 2023 (apel juridiksion i përgjithshëm dhe administrativ). Në këtë rast prioritetet e KLGJ-së ishin në emërimin dhe caktimin në pozicion të magistratëve të sapodiplomuar si edhe përfundimin e disa procedurave të lëvizjeve paralele. Kandidati për ngritje në detyrë kalon në procedurë vlerësimi etik dhe profesional. Vlerësimi është bazë për zhvillimin e karrierës së gjyqararit. Në këto kushte, në bazë të parimit të procesit të rregullt ligjor, kandidati njoftohet për rezultatet e vlerësimit dhe ka të drejtën të ankimojë në Gjykatën Administrative të Apelit, vendimin për vlerësim. Shqyrtimi gjyqësor i çështjes pezullon vijueshmërinë e procedurës së ngritjes në detyrë. Prandaj edhe kohezgjatja referuar rastit që citohet në raport është kushtëzuar nga ecuria e gjykimit.

9.2. Komente të KShH-së:

KShH thekson se proceset administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, përfshijnë procedura administrative të ndërvaruara, të cilat sipas analizës së rasteve të caktuara, rezulton se zgjasin nga 6 muaj deri mbi 2 vjet. Prandaj, KSHH vlerëson se kërkohet një analizim më i thelluar i faktorëve që ndikojnë në vështirësitë e hasura për një mbarëvajtje normale 6 muaj të këtyre procedurave, me synimin për të krijuar mekanizmat e duhur të menaxhimit, që të minimizohen sa më shumë zvarritjet në këtë proces. Kështu, vlerësohet se faktorë ngadalësues në procedura të tilla janë: ndërlidhja me procedura administrative që kërkojnë bashkëveprim me institucione të tjera për: (1) verifikimin e pasurisë, (2) për verifikimin e të dhënave për figurën e gjyqtarit, (3) ndjekjen dhe pritjen e rezultateve të ankimimeve të kryera nga ana e gjyqtarëve për garantimin e të drejtave të tyre në respektim të procedurave e vlerësimit, (4) pritja e rezultateve të procesit të vetingut për kandidatët që janë subjekte të këtij procesi etj.

10. Konstatime në draft raportin e KShH-së

KShH ka evidentuar se ankesat e administruara brenda afatit ligjor pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të vijonë të trajtohen nga ILD pasi bazuar në parimin e vazhdimësisë institucionale tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve (*Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligjit Nr.115/2016*). Në vlerësimin e KShH-së, në respekt të parimit të vazhdimësisë së juridiksionit të institucioneve të reja të drejtësisë, është përgjegjësi e ILD dhe KLGJ për procedimin disiplinor të magistratëve edhe për zgjidhjen e çështjeve të mbartura, sipas nenit 117 të Ligjit Nr.115/2016. Rrjedhimisht, KShH i sugjeron KLGJ të rishikojë nëpërmjet “*Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave të arkivuara të ILD-së*”, çdo praktikë të ILD për mbylljen e procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura, të cilat kanë qënë në listë pritje për shkak të reformimit të institucioneve. Ky qëndrim është i rëndësishëm për evitimin e praktikës që po krijohet bazuar në precedentin negativ, KLGJ ka marrë disa vendime për pranimin e kërkesës së ILD-së për mbylljen e procedimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkaqeve të shkeljes së pretenduar.¹⁰⁴

10.1. Komente të KLGJ-së:

Vlen të theksojmë se Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, në çdo rast vendimarrjen e tij bazohet në dispozitat ligjore si vijon: Neni 18 i Rregullores së Komisionit të Përkohshëm (KPSHA) përcakton se: “*Kufijtë e shqyrtimit të ankimit janë brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në të*”. Ndërsa në nenin 26 të po kësaj Rregulloreje, në përputhje me parashikimet e nenit 62 pika 13 e Ligjit 115/2016, parashikohet se : “*Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioni vendos : a) refuzimin e ankimit si të pabazuar; b) shfuqizimin e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe, sipas rastit, urdhërimit të Inspektorit të lartë të Drejtësisë për verifikimin e ankesës së arkivuar ose vazhdimin e hetimit ndaj një gjyqtari*”. Bazuar në këtë rast shqyrtimi, vlerësohet se: Në referim të parashikimeve ligjore, nenit 122 dhe 123 të Ligjit 96/2016, pas verifikimit të ankesës, ILD mund të disponojë vetëm një nga këto mënyra: a) të vendosë fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit ose b) të arkivojë ankesën. Një nga kushtet që duhet të plotësohet në momentin e marrjes së vendimit “Për fillimin e hetimit të disiplinor ndaj gjyqtarit” është ai mungesës së parashkrimit të shkeljes disiplinore, kusht i parashikuar në nenin 117 të Ligjit 96/2016, sipas të cilit shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. Pavarësisht se në nenin 123 të Ligjit 96/2016 nuk parashikohet shprehimisht ndalimi i fillimit të hetimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkeljes disiplinore, ku konkluzion arrihet nga interpretimi i dy dispozitave të ligjit si më poshtë:

-Neni 123 pika 1 të Ligjit 96/2016 i cili parashikon: “*Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit*”.

¹⁰⁴Vendim i KLGJ-së nr.717, datë 06.12.2023 për caktimin e relatorit dhe seancës dëgjimore për procedimin disiplinor të magistratit; Vendim i KLGJ-së nr. 702/2023, “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

-Nenit 134 të Ligjit 96/2016 i cili parashikon : “Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore; b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor; **c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;** ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji; d) magjistrati ka vdekur”.

Mungesa e parashkrimit të shkeljes disiplinore duhet të ekzistojë jo vetëm në momentin e paraqitjes së ankesës, por edhe në momentin deri kur ILD merr vendim për fillimin e hetimit disiplinor. Për shkak të pamundësisë ligjore për të vazhduar verifikimin deri në fillimin e hetimit disiplinor, për sa kohë që faktet që prashtrohen nga ankuesi lidhen me ngjarje të cilat kanë ndodhur përtej periudhës 5 vjeçare të parashkrimit, me të drejtë konkludohet për arkivimin e ankesës. Ky është rasti në të cilin parashkrimi shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë administrativisht shkeljen disiplinore që pretendohet të jetë kryer nga magjistrati për shkak të kalimit të një kohe të caktuar nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore.

10.2. Komente të KShH-së:

KShH vlerëson se në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe parimit të vazhdimësisë institucionale, duhet të evitohet kjo praktikë për mbylljen e procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura, të iniciuara nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (KLD dhe MD). Nenit 134 i Ligjit 96/2016 parashikon se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:**c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;...**”. Ky nen gjen zbatim për një situatë normale kur çështja është parashkruar në momentin e hetimit të filluar nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (përkatësisht Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i lartë i Drejtësisë). Për sa kohë, procedimet e mbartura nuk kanë pasur shkaqe parashkrimi në kohën e shqyrtimit të tyre nga institucionet e vjetra të drejtësisë, nuk mund të zbatohet neni 134 i ligjit 96/2016 për shkaqe objektive që lidhen me situata të jashtëzakonshme për shkak të reformave të thella institucionale që kanë çuar në krijimin e institucioneve të reja të ILD-së dhe të KLGJ-së. Në kushtet, kur shkaqet e vonësive nuk lidhen drejtpërdrejt me procedimet disiplinore të mbartura, por janë përgjegjësi institucionale e organeve të reja të drejtësisë në respektim të parimit të vazhdimësisë institucionale, nuk mund të gjejë hapësirë zbatimi i nenit 134 për të justifikuar arkivimin e procedimeve të mbartura me argumentimin se janë parashkruar shkaqet e shkeljes. Në këtë drejtim, për korrigjimin e kësaj praktike, KLGJ-së i rekomandohet të rishikojë me nismën e vetë çdo praktikë të arkivuar, sipas nenit 99 të Ligjit 115/96 “Për qeverisjen e institucioneve të qeverisjes së drejtësisë”, me synim që të konsiderojë anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve të ILD-së, për mbylljen e procedimeve disiplinore, sipas kërkesave që kanë qënë në listë pritje për shkak të reformimit të institucioneve.

B. Në lidhje me gjetjet për veprimtarinë e ILD-së

1. Konstatime të KSHH-së në raport

KShH vëren se për procedimet disiplinore të mbartura nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (*Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë*), ILD ka ndjekur si praktikë arkivimin e kërkesave ose mbylljen e procedimit, duke argumentuar se shkaqet e shkeljeve janë parashkruar sipas ligjit të mëparshëm. KShH vlerëson se kjo praktikë nuk është e drejtë pasi në respektim të parimit të vazhdimësisë institucionale, tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve dhe jo për faj të ankuesve.¹⁰⁵

1.1 Komente të ILD-së

Ky vërtetim i KSHH-së është i pambështetur, pasi ILD me marrjen e praktikave të trashëguara nga institucionet e mëparshme kompetente për hetimin dhe procedimin disiplinor të magjistratëve, të transferuara nga KLGJ, MD dhe KLP, ka bërë një proces kategorizimi me marrjen e tyre në dorëzim. Ky proces ka patur për qëllim pikërisht, vlerësimin e secilës praktikë të marrë për fazën apo gjendjen e saj procedurale. ILD me burimet njerëzore të kohës, ka kategorizuar secilën praktikë sipas një radhe përparësie, ku ndër të tjera, ka përcaktuar kriterin e kronologjisë së regjistrimit të ankesës, fazën procedurale ku ndodhej praktika si dhe kritere të tjera që do t'i shërbenin përmbylljes së shqyrtimit të ankesave.

ILD ka trashëguar një numër të lartë prej 2104 ankesash në faza të ndryshme procedurale, të cilat edhe sipas dispozitave tranzitore të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht neni 170 i tij, duhej të ishin finalizuar nga vetë organet e mëparshme disiplinore. Jo vetëm që në ILD u transferuan praktika të filluara, por nuk u aplikua i njëjti standard, sa i takon burimeve njerëzore, veçanërisht inspektorë, sikurse kërkohej nga parashikimet e bëra në nenin 168, pika 3 të ligjit nr. 96/2016. Ndjekja dhe zbatimi nga organet kompetente i këtyre parashikimeve do të garantonte kalimin e proceseve të punës, e më tej edhe sigurimin e vijueshmërisë institucionale, të 2104 praktikave të trashëguara.

Formulimi “*ILD ka ndjekur si praktikë arkivimin e kërkesave ose mbylljen e procedimit duke argumentuar se shkaqet e shkeljeve disiplinore janë parashkruar sipas ligjit të mëparshëm*”, jo vetëm që nuk është korrekt në përdorimin e termave, por rezulton të jetë paragjykes, kjo pasi kriteret dhe procedurat për pranueshmërinë ose jo të ankesave janë parashikuar në nenet 120-122 të ligjit 96/2016, dhe arkivimi aplikohet kur pas shqyrtimit fillestar, apo pas verifikimit në përputhje me kriteret ligjore për këtë qëllim, nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit. Pra ankesa arkivohet. Nga praktikat e pambyllura të dorëzuara nga KLGJ për periudhën 2020-2023, janë ndërmarrë 26 hetime, prej të cilave janë propozuar 11 kërkesa për procedim

¹⁰⁵ Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

disiplinor pranë KLGJ-së. Nëse KShH ka konstatuar praktikë, ju lutem të na evidentoni rastet konkrete.

Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka parashikuar edhe mjetin e ankimit ndaj vendimmarrjeve të ILD-së, për arkivim dhe mbyllje hetimi. Këto vendimmarrje, që prej fillimit të veprimtarisë së ILD-së, nuk janë cënuar në asnjë rast, pra nuk janë kthyer për rishqyrtim nga komisionet e përhershme në Këshilla për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimit të ILD-së. Referuar sa më sipër, ky paragraf dhe konkluzionet e nxjerra në të, duhet të rishikohen sipas komenteve të mësipërme.

1.2. Komente të KSHH-së

KSHH i referohet pikërisht rasteve kur për trajtimin e ankesave të mbartura nga ish KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme, apo Ministria e Drejtësisë, nga ana e institucionit të ILD është vendosur arkivimi ose mbyllja e procedimit duke argumentuar se për këto raste janë parashtrkuar afatet e shkeljeve, objekt i hetimit disiplinor, për shkak të kohës mbi 5 vjet që ka kaluar për shqyrtimin e tyre si rezultat i reformimit të institucioneve të reja. Një rast i tillë është analizuar në përmbajtjen e këtij raporti.¹⁰⁶ Në lidhje me këto raste, KSHH ndan një vlerësim të ndryshëm dhe ILD-së i sugjerohet të ndryshojë argumentimin ligjor, në mënyrë që të vijojë trajtimi i rasteve të mbartura duke mos përllogaritur afatet që i është dashur ILD-së të krijohet për shkak të reformës kushtetuese gjyqësore. Kjo pasi, reformimi i institucioneve të reja nuk mund të përbëjë një shkak ligjor që pengon vijueshmërinë institucionale për trajtimin e rasteve të mbartura.

Konstatime në raportin e KSHH-së

Është e nevojshme të zhvillohet një koordinim sa më efikas ndërinstitutional mes ILD-së dhe KLGJ-së, për menaxhimin e zvarritjeve të seancave plenare për procedimin disiplinor, për shkak të mungesës së përsëritur të gjyqtarit që është subjekt i këtij procedimi. Ky koordinim duhet të ketë në fokus edhe integrimin e të dhënave mbi procedimet disiplinore.¹⁰⁷ Për këtë qëllim, KShH vlerëson se KLGJ duhet të publikojë procesverbalet dhe aktet administrative për procedimet disiplinore në një rubrikë të dedikuar vetëm për procedimet disiplinore, me qëllim që përdoruesit e faqes të jenë sa më të orientuar në gjetjen e informacionit. Në mënyrë që të sigurohet menaxhim i integruar i të dhënave për procedurat disiplinore të gjyqtarëve, ILD inkurajohet të krijojë në faqen zyrtare regjistrin me të dhëna mbi trajtimin e ankesave dhe hetimeve administrative disiplinore.

Komente të ILD-së

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që prej krijimit, si institucion i ri, që ka ndërtuar gjithçka për së pari, edhe faqen e internetit, ka patur në vëmendje të posaçme transmetimin në publik të

¹⁰⁶ Si psh, Vendime KLGJ-se nr. 723, datë 07.12.2023, “Për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës”

¹⁰⁷ Të dhëna duke respektuar kriteret për masat disiplinore sipas kategorive si, vërejtjet, pezullimet, shkarkimet (nenet 100-116 të ligjit për statusin)

veprimtarisë së vet, jo vetëm në kuadër të detyrimeve për transparencë, por si objektiv institucional për të pasqyruar çdo informacion të lidhur me veprimtarinë, në mënyrë të thjeshtuar dhe ndërgjegjësores, si pjesë e edukimit ligjor që ILD kishte nevojë ta bënte që ditën e parë, pikërisht se ishte institucion krejt i ri. Në mënyrë sistematike, në faqen e internetit pasqyrohet informacion mbi funksionin dhe rolin kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes formave të thjeshtuara të komunikimit, e përcjellja e të dhënave në formate grafike, audiovizuale, narrative (në formë lajmi) dhe statistikore. Informacioni statistikor është i plotë, lehtësisht i aksesueshëm dhe çdo të hënë përditësohet me të dhënat e përpunimit të një jave pune, pra: 1- me numrin e ankesave të administruara, 2- atyre të trajtuara, 3- atyre në proces trajtimi, 4- ankesave në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, 5- numrin e hetimeve të realizuara dhe 6- numrin e kërkesave për procedim. Këto të dhëna përmbledhin veprimtarinë e ILD që prej nisjes së funksionimit. Jo vetëm gjatë vitit 2023, por as gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së ILD-së, nuk ka patur ndonjë kërkesë, ankesë apo pretendim, lidhur me paraqitjen e informacionit mbi statistikën, apo për lehtësinë e kërimit të informacionit në faqe. Krijimi i një regjistri për këtë çështje shihet i panevojshëm. Ku konstatohet mungesa e transparencës në këtë rast?

Përgjigje e KSHH-së ndaj komenteve të ILD-së

Në këtë konstatim, KSHH inkurajon ILD që përveç publikimit të statistikave të përmbushë dhe krijimin e një regjistri mbi kërkesat dhe rastet që kalojnë në hetim disiplinor, deri tek dalja e ILD-së me vendim mbi mënyrën e zgjidhjes së tyre. Këto të dhëna janë të rëndësishme në drejtim të garancive për menaxhimin e proceseve disiplinore, sidomos në drejtim të kohëzgjatjes sa më normale të tyre, nisur dhe nga kërkesat e drejtësisë procedurale për këtë procedurë. Procedimi disiplinor fillon në institucionin e ILD-së dhe më pas procedohet në mbledhjen plenare të KLGJ-së. KSHH vlerëson se është e nevojshme të pasqyrohen të dhëna mbi objektin dhe natyrën e ankesave deri tek shkeljet e gjetura në rast të vendimeve për masa disiplinore ndaj magjistratit. Për këtë inkurajohen të koordinohen të dyja institucionet për të mundësuar një monitorim të vazhdueshëm të seancave për të evidentuar shkaqet për shtyrjen e tyre. Për këtë KSHH ka rekomanduar jo vetëm marrëveshje bashkëpunimi mes dy institucioneve por dhe një menaxhim të të dhënave statistikore për këto seanca, të cilat duhet të publikohen respektivisht për secilën fazë, për të mundësuar aksesimin e të dhënave mbi kohëzgjatjen, natyrën e shkeljeve dhe pjesën arsyetuese të vendimeve. Ky rekomandim është i përbashkët për të dyja institucionet dhe KLGJ e ka pranuar dhe ka shprehur vullnetin për të publikuar në të ardhmen të dhënat mbi procedimet disiplinore në një rubrikë të dedikuar vetëm për këto procedime. Në të njëjtën frymë inkurajohet dhe institucioni i ILD-së për të publikuar në një regjister të veçantë të dhëna mbi hetimet disiplinore. **KSHH e shikon të arsyeshme nevojën për bashkërendimin e masave midis dy institucioneve, për aksesin në të dhënat mbi natyrën dhe objektin e hetimeve disiplinore dhe seancave plenare të KLGJ-së, për përmirësimin e transparencës nga pikëpamja e respektimit të standartit të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, ato ndihmojnë në transparencën ndaj publikut dhe krijimit të besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.**

3. Konstatime në raportin e KSHH-së

Së fundi, institucioni i ILD-së edhe pse përballet me administrimin e 2340 ankesave përfshirë dhe ato të mbartura nga viti i kaluar, volumi i punës që mbulon ky institucion për 18 hetime disiplinore nuk përmbush në vlerësimin e KShH-së standartet e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së gjyqësorit. Këtë konkluzion e bazojmë edhe në faktin krahasimor të volumit mesatar të ngarkesës së gjyqtarëve përgjatë një viti që sipas raportit të KLGJ-së për vitin 2023 arrin 841 çështje për gjyqtar.¹⁰⁸

Komente të ILD-së

Lidhur me vlerësimin e KSHH-së për numrin e ulët të hetimeve gjatë vitit 2023 në raport me numrin e ankesave, rikujtojmë se është thelbësore të kuptohet qartë, se një hetim disiplinor fillon pas dyshimeve të arsyeshme, se shkelja e pretenduar mund të jetë kryer. Pikërisht, cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve që përbëjnë shkak për një hetim disiplinor është dallimi ndërmjet ankesave/informacioneve të denoncuar që arkivohen dhe atyre që hetohen. Hetimi i shkeljeve disiplinore nga ana e magjistratëve, ecën paralelisht me respektimin e pavarësisë së magjistratëve, si një balancë që i jep vlerë shtetit të së drejtës.

Hetimi disiplinor i realizuar nuk ka patur si qëllim, hetimin e një numri të lartë magjistratësh, por shqyrtimin e interesave të ligjshëm të ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është hetuar, duke gjykuar në mënyrë proporcionale dhe duke dokumentuar të gjitha provat dhe dëshmitë e paraqitura nga njëra anë dhe duke respektuar të drejtat e magjistratit subjekt hetimi. Për çdo rast të hetuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit, që varësisht rastit ka volumin e vet, ka vlerësuar dëshmitë dhe ka qartësuar rrethanat që kanë diktuar nisjen e hetimit, në mënyrë që përfundimet e veprimeve hetimore të jenë të plota dhe të pakontestueshme.

Standardet e BE-së dhe GJEDNJ-së kërkojnë hetim objektiv, të paanshëm dhe sipas një procesi të rregullt ligjor, me propozime që i atribuohen sjelljes së magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës por dhe jashtë saj, konform standardeve të përcaktuara dhe jo domosdoshmërisht një numër të lartë hetimesh për të krijuar efekt statistikor.

Për shkak të ndërlidhjes që kanë, komentet e KSHH-së për këtë pikë do integrohen në komentet për konstatimin vijues në pikën 4.

Konstatime në raportin e KSHH-së

Disa nga prioritetet kyç që KLGJ ka vendosur në dokumentat e tij strategjike si: raportet vjetore të punës për vitin 2023, plani strategjik i vitit 2022-2024, si dhe raportet e komisioneve të përhershme për vitin 2023, të cilat janë në fokus të monitorimit të KShH-së, janë si vijon:

Promovimi dhe përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve

¹⁰⁸Shih raporti vjetor i KLGJ-së, faqe 93.

Edhe pse plotësimi i vakancave nëpër gjykata ka qënë objektiv kryesor për KLGJ-në nëpërmjet promovimit të gjyqtarëve përmes lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo komandimeve, rezultoni se procedimet disiplinore nuk kanë pasur të njëjtin trend. Kështu konstatohet se ILD dhe KLGJ nuk kanë pasur mjaftueshëm produktivitet për garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve, pasi numri total i ankesave për procedurat disiplinore që administrohen nga ILD është ndjeshëm jo proporcional në raport me procedimet disiplinore që konkludohen me kërkesë për inicim tek KLGJ.

Komente të ILD-së

Koment faqe 13,“Lidhur me formulimin “konstatohet se ILD dhe KLGJ nuk kanë pasur mjaftueshëm produktivitet për garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve, pasi numri total i ankesave për procedurat disiplinore që administrohen nga ILD është ndjeshëm jo proporcional në raport me procedimet disiplinore që konkludohen me kërkesë për inicim tek KLGJ.”

Analiza e bërë nga KSHH është e gabuar pasi për çdo procedim disiplinor të paraqitur, duhej parë numri i ankesave që i kanë dhënë shkak procedimit, por kurrësi, numrit total i të gjitha ankesave, të cilat në pjesën dërmuese të tyre, nuk janë të bazuara mbi kriteret që përcakton ligji për pranimin e tyre. Për shembull, për një procedim që është aktualisht në KLGJ, shkak për hetimin janë bërë plot 11 ankesa nga subjekte të ndryshme. Prandaj kjo analizë duhet ndryshuar, në mënyrë që të analizohet cilësisht raporti i ankesave që janë të bazuara dhe i kanë dhënë shkak hetimit e më pas procedimit, për rrjedhojë nxjerrjen e konkluzioneve të sakta e të mbështetura.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në standardet e ngritura për hetimin dhe procedimin disiplinor, për çdo pretendim të ngritur, analizon dhe provon faktet që i atribuohen sjelljes së magjistratit. Fakt është se të gjitha këto standarde janë lënë në fuqi, kur masat e propozuara dhe të pranuar nga KLGJ, i janë nënshtruar gjykimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në Gjykatën Kushtetuese.

Komente të KSHH

Qëllimi parësor i reformës kushtetuese gjyqësore ka qënë pikërsiht thyerja e mitit të pandëshkueshmërisë ndaj magjistratëve çfarë krijoi dhe nevojën për një reformim të thellë institucional të institucioneve të drejtësisë, për krijimin e institucioneve të posaçme për hetimin disiplinor të magjistratëve. Rezultatet e arritura nga ILD në drejtim të hetimeve të rasteve janë një tregues sasior i pamjaftueshëm në drejtim të materializimit të përgjegjësisë së përbashkët institucionale me KLGJ dhe KLP për të mundësuar një hetim sa më koherent dhe efikas të magjistratëve, krahasuar me ish institucionet e vjetra të drejtësisë si ish KLD, MD dhe PP. KSHH arrin në këtë konkluzion duke patur në konsideratë një sërë faktorësh, si ankesat e qytetarëve për zvarritje të proceseve gjyqësore, deri në vonesa të pajustificuara për zbardhje të vendimit gjyqësor të arsyetuar, rezultatet e procesit të vettingut, ku afro gjysma e gjyqtarëve dhe prokurorëve u gjenden me problematika, kryesisht në drejtim të pasurisë, por edhe në raport me kriterin e profesionalizmit, si dhe ecuria e mëparshme e procedimeve disiplinore nga ish institucionet e drejtësisë, përgjegjëse të kohës.

KShH dëshiron të theksojë se përgjegjësia disiplinore e magistratëve sipas legjislacionit të ri nuk duhet të synojë në largimin e tyre, nëse shkeljet nuk janë të rënda, por në zbatimin e masave proporcionale me efekt parandalues që ndihmojnë në forcimin e karrierës së tyre, llogaridhënies, profesionalizmit dhe shërbimit publik që duhet të ofrojnë me përgjegjshmëri ndaj qytetarit.

Konstatime të KSHH-së

Nga analiza e akteve të përzgjedhura, KShH vëren me shqetësim një praktikë të konsoliduar të KLGJ-së dhe ILD-së për mbylljen e procedimeve disiplinore, për shkak të parashkrimit të shkaqeve, kur çështja është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë (MD), në referim të ligjit të mëparshëm. Kështu, sipas një rasti¹⁰⁹ për procedimin disiplinor ndaj një magjistrati, në vitin 2012 Ministria e Drejtësisë kishte propozuar masën disiplinore “Shkarkim nga detyra” para ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë,¹¹⁰ rezulton se ky rast është përmbyllur në vitin 2023, pas 11 vitesh për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore.¹¹¹ Gjatë këtij harkut kohor prej 11 vitesh janë ndërmarrë këto veprime për trajtimin e këtij rasti:

Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, deri në përfundimin e shqyrtimit;¹¹²

Dërgimi i çështjes për kompetencë tek ILD;¹¹³

Dërgimi për kompetencë tek KLGJ për verifikimin e rënies së shkakut të pezullimit;¹¹⁴

Vendimi i KLGJ për plotësimin e kushteve të rënies së shkaqeve të pezullimit;¹¹⁵

Caktimi i relatorit dhe seancës dëgjimore nga ana e KLGJ-së;

Kërkesë nga ana e ILD-së për mbylljen e procedimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkeljeve.

Nga ky rast vlen të evidentohet se ILD ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar të rasteve analoge, duke vendosur për arkivimin e kërkesave ose mbylljen e procedimit. KShH vlerëson se kjo praktikë nuk është e drejtë, duke ju referuar rasteve për mbylljen e procedimeve disiplinore të mbartura nga institucionet e mëparshme të drejtësisë (*Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë*). Sipas ILD-së kjo praktikë është e justifikuar për shkak të parashkrimit të shkaqeve të

¹⁰⁹Vendime KLGJ-se nr. 723, datë 07.12.2023, “Për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës”

¹¹⁰Me shkresat nr. 4281/3 prot., datë 01.10.2012 dhe nr. 6127/17, datë 26.10.2012

¹¹¹Mbështetur në nenet 147, 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 117, 139 dhe 172 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

¹¹²Me kërkesën e MD nr. 486 prot., datë 23.01.2013, si dhe me kërkesën nr. 486/1 prot, datë 10.07.2013

¹¹³Me shkresën nr. 3696/1 prot., datë 30.06.2023

¹¹⁴Me shkresën nr. 2170/1 prot., datë 28.07.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3696/2 prot., datë 31.07.2023,

¹¹⁵Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 702 datë 30.11.2023 vendosi: “1. Shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 19.07.2013 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.

shkeljeve, të cilat kanë ndodhur në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit 8 gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.¹¹⁶

Komente të ILD-së

Koment faqe 29, rubrika “7. Procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve” paragrafi i pestë dhe i gjashtë, sa i takon mbylljes së procedimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkaqeve, kur çështja është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2012. ILD ka marrë dijeni të këtij procedimi dhe faktit të pezullimit të procedimit nga MD, nga komunikimi i KLGJ në qershor të vitit 2023, duke i kërkuar KLGJ-së zhvillimin e një procesi mbi verifikimin e rënies apo ekzistencës së shkakut të pezullimit. Pas arsyetimit të KLGJ-së, mbi rënien e shkakut të pezullimit që lidhet me përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatat më të larta, KLGJ ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të KLD për pezullimin dhe vijimin e procedimit, duke i njoftuar këtë vendim ILD-së. Nga analizimi i dispozitave të ligjit të zbatueshëm në kohën kur kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, për shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratët ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 34, pika 2, parashikonte se: “Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes”. ILD ka konkluduar për mbylljen e procedimit, pasi shkelja është parashkruar. Instituti i parashkrimit të procedimit disiplinor të magjistratit ka qenë parashikuar në nenin 34, pika 2, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes. I njëjti parim që lidhet me institutin e parashkrimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit për efekt të sigurisë juridike, parashikohet edhe në ligjin nr. 96/2016. Referuar nenit 117 të këtij ligji, “shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve dhe se afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer”. Gjithashtu, kjo dispozitë parashikon edhe rastin se kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit.

Në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk ka dispozitë analoge si ajo e nenit 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, i cili në pikën 5 parashikon se: “Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117 i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë”.

¹¹⁶Në kohën kur kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, për shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratët ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit 8 gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 34, pika 2, parashikonte se: “Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes”.

Për sa më sipër, rezulton se shkeljet e pretenduara për të cilat ka nisur procedimi disiplinor ndaj magjistratit, dhe të cilat kanë të bëjnë me vendime gjyqësore të vitit 2009 dhe 2012, janë parashkruar. Instituti i parashkrimit shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë dhe të japë vendim për masë disiplinore ndaj magjistratit për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, afat i cili llogaritet nga momenti i kryerjes së shkeljes së pretenduar. Respektimi i afatit të parashikuar për kryerjen e procedimeve disiplinore është në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

Komente të KSHH

KShH e ka evidentuar këtë praktikë dhe në raporte të tjera, për çështje për të cilat ka ndjekur edhe rrugën gjyqësore të ankimit pasi është ankuar fillimisht pranë KLGJ-së. KShH ripërsërit mendimin e tij të pavarur se ankesat e administruara brenda afatit ligjor pranë ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të vijonin të trajtoheshin nga ILD, pasi bazuar në parimin e vazhdimësisë institucionale, tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve (*Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligjit Nr.115/2016*). Në vlerësimin e KShH-së, në respekt të parimit të vazhdimësisë së juridiksionit të institucioneve të reja të drejtësisë, është përgjegjësi e ILD dhe KLGJ për procedimin disiplinor të magjistratëve edhe për zgjidhjen e çështjeve të mbartura, sipas nenit 117 të Ligjit Nr.115/2016.

Konstatime në raportin e KSHH-së

Gjatë këtij viti, të gjitha kërkesat e paraqitura kanë qënë në fazë shqyrtimi nga ana e Këshillit. Sipas raportit për planin strategjik, shkak për ecurinë e ngadaltë të trajtimit të ankesave është mungesa e stafit prej 11 inspektorësh në këtë institucion. Në çdo rast, KShH vlerëson se krahas faktit se ky institucion aktualisht ushtron veprimtarinë me burime njerëzore të kufizuara, nga ana tjetër, ndjek një numër modest të procedurave që finalizohen me fillim hetimesh të masave disiplinore, përkatësisht 18 të tilla për vitin 2023. Edhe pse institucioni administron 2340 ankesa përfshirë dhe ato të mbartura nga vitet e kaluara, volumi i punës që mbulon ILD për 18 hetime disiplinore është larg pritshmërive, nëse krahasojmë përshembull volumin ose ngarkesën mesatare të gjyqtarëve përgjatë një viti e cila për vitin 2023 ka qënë 841 çështje për gjyqtar.

Gjetje: Gjatë vitit 2023, ILD rezulton të ketë trajtuar 2340 ankesa, nga të cilat 1268 janë ankesa të depozituara pranë ILD-së dhe 1072 janë ankesa të fondit “backlog” (*të mbartura para krijimit të ILD*). Pas shqyrtimit të ankesave, ILD ka miratuar 1631 vendime, nga të cilat:

1061 vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të 1616 ankesave;

552 vendime për arkivimin pas verifikimit, të 707 ankesave;

16 vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit, të 17 ankesave;

2 vendime për hetim disiplinor të nisura me iniciativë nga ILD.

Komente të ILD-së

Fq. 30, për numrin e ulët të 18 hetimeve lidhur me këtë koment, numri i ulët i procedimeve në raport me numrin e lartë të ankesave, nuk është tregues kjo për shkakun kryesor të paraqitur në argumentet për paragrafin e tretë në faqen 9 të raportit të KSHH. Të gjitha organet kompetente në procedimin disiplinor udhëhiqen në punën e tyre nga parimet e sanksionuara në neni 100 të ligjit nr. 96/2016, duke cilësuar ato pretendime që plotësojnë kushtet ligjore për të justifikuar një hetim. Numri i lartë i ankesave nuk përbën tregues për numrin e hetimeve, por për nevojën e lartë për ndërgjegjësim të publikut në lidhje me pretendimet, që i japin shkak procedimit disiplinor.

Por gjithashtu edhe konkluzioneve që duhet të dalin nga shkaqet e arkivimit të ankesave të cilat nuk janë vlerësuar në këtë raport. Theksohet se numri i lartë i ankesave nuk është tregues për hetimet apo rrjedhimisht për hetimet, por bazueshmëria e tyre në kriteret dhe procedurën e përcaktuara në ligj.

Nga hartuesit e raportit, nuk është marrë në konsideratë analiza e shkaqeve të arkivimit, e cila vjen si rrjedhojë edhe pretendime të ngritura për:

Pretendimet që nuk përbëjnë shkelje disiplinore;

Veprime/mosveprime të cilat janë objekt i kontrollit i shkallëve më të larta të sistemit gjyqësor;

Subjekte të cilën nuk janë nën fushën e përgjegjësisë së ILD-së (kancelar/sekretar gjyqësor/oficerë të policisë gjyqësore/avokatë/përmbarues/ekspertë etj;

Magjistratë të shkarkuar nga vetting e për pasojë nuk ka më lëndë për shqyrtimin e pretendimeve

Magjistratë të dalë në pension apo të dorëhequr.

Komente të KSHH

Lidhur me këtë koment të ILD-së, KSHH ripërsërit të njëjtin argument, të pasqyruar në paragrafin 4.2 të këtij raporti (pjesë e këtij aneksi).

Konstatime të KSHH-së

“Pavarësisht sa më sipër, KShH vlerëson se faqja zyrtare e ILD-së nuk siguron akses me të dhëna statistikore të mjaftueshme mbi veprimtarinë e tij, sa i përket hetimeve disiplinore, të cilat mund të përmirësojnë transparencën e institucionit.”

Komente të ILD-së

Koment faqe 31, rubrika “..ILD është në përpjekje të vazhdueshme të reformimit të proceseve të brendshme të punës, në përputhje me detyrimet ligjore, por edhe në funksion të transparencës

së veprimtarisë. Përpunimi i informacionit statistikor, gjeneron të dhëna të përditësuara çdo fillim jave mbi numrin e ankesave të shqyrtuara dhe atyre në proces, hetimet e kryera dhe numrin e kërkesave për procedim disiplinor dhe publikimi i njoftimeve për çdo vendim procedimi që jepet nga Këshillat. Shiko sqarimin tek “**Koment faqe 9**, “Procedurat disiplinore”, paragrafi i dytë fjalia e katërt”.

Detyrimi ligjor i ILD-së është të njoftojë palët në proces, sipas çdo vendimmarrje në kompetencë të tij, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor, duke garantuar kështu parimet e një procesi të rregullt. Ecuria e hetimit disiplinor ka karakter konfidencial dhe ushtrohet në mënyrë të përshtatshme, të balancuar dhe proporcionale duke garantuar mbrojtjen e integritetit dhe figurës së magjistratit nga akuzat e pabaza.

Megjithatë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, krijimi i një regjistri do të mbahet parasysh, në të ardhmen.

Po këtu, lidhur me formulimin “*Të vetmet dokumenta që ofrojnë informacion janë raportet vjetore të punës dhe buletinët mujorë, të cilët nuk sigurojnë të dhëna të mjaftueshme statistike.*” Vlerësimi nuk qëndron në koncept, pasi raporti vjetor i ILD-së është dokumenti më i rëndësishëm, që pasqyron të gjithë veprimtarinë e institucionit gjatë një viti kalendarik. Raporti vjetor paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë dhe është shterues në informacion. Ndërsa Buletinët mujorë përcjellin, me saktësi protokollare, çdo të dhënë statistike të proceseve të punës, që nga shqyrtimi i ankesës deri tek kërkesa për procedim disiplinor gjatë një muaji kalendarik pune. Megjithatë nëse në vlerësimin e KShH ka mungesa, a mund të specifikohet se cila e dhënë pune mungon në raportin vjetor apo në buletinin mujor, në mënyrë që ta kemi parasysh?

8.2. Komente të KSH

Për garantimin e parimit të një procesi të rregullt, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor, KSHH ripërsërit nevojën për bashkërendimin e të dhënave statistike nga ana e dy institucioneve të ILD-së dhe KLGJ-së mbi publikimin në faqen zyrtare të një regjistri me të dhënat respektive mbi procedurat e ndjekura nga secili institucion, brenda fushës së kompetencës. KSHH përshendet faktin se të dyja institucionet, si KLGJ dhe ILD kanë shprehur vullnetin e qartë për mundësimin e krijimit të regjistrave përkatës që do ndihmojnë në transparencën e të dhënave statistike lidhur me hetimin dhe procedimin disiplinor të magjistratëve. KSHH vlerëson se raportet vjetore të punës ashtu dhe buletinët mujorë janë dokumenta të rëndësishëm që ofrojnë një prezantim të veprimtarisë së ILD-së nëpërmjet shifrave sasiore lidhur me numrin e ankesave, të vendimeve, si dhe natyrën e shkeljeve të konstatuara. Megjithatë, në këndvështrimin e një analize të detajuar mbi transparencën karshi publikut si mbartës të së drejtës për të bërë ankime e po ashtu të aspekteve procedurale të procesit të hetimit disiplinor, KShH vlerëson se është e nevojshme të sigurohen të dhëna shtesë që mundësojnë një analizë cilësore për natyrën e problematikave të përcjella në ILD nëpërmjet ankesave, kohëzgjatjen e procedimit disiplinor si dhe mënyrën se si janë respektuar garancitë procedurale të palëve.

9. Konstatime në raportin e KSHH-së

KShH ka evidentuar se ankesat e administruara brenda afatit ligjor pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të vijonë të trajtohen nga ILD pasi bazuar në parimin e vazhdimësisë institucionale tejkalimi i kohës së arsyeshme të trajtimit të ankesës ka ardhur si pasojë e përgjegjësisë së institucioneve (*Neni 283, pika 9 dhe pika 11 e Ligjit Nr.115/2016*). Në vlerësimin e KShH-së, në respekt të parimit të vazhdimësisë së juridiksionit të institucioneve të reja të drejtësisë, është përgjegjësi e ILD dhe KLGJ për procedimin disiplinor të magistratëve edhe për zgjidhjen e çështjeve të mbartura, sipas nenit 117 të Ligjit Nr.115/2016. Rrjedhimisht, KShH i sugjeron KLGJ të rishikojë nëpërmjet “Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankesave të arkivuara të ILD-së”, çdo praktikë të ILD për mbylljen e procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura, të cilat kanë qënë në listë pritje për shkak të reformimit të institucioneve. Ky qëndrim është i rëndësishëm për evitimin e praktikës që po krijohet bazuar në precedentin negativ, KLGJ ka marrë disa vendime për pranimin e kërkesës së ILD-së për mbylljen e procedimit disiplinor për shkak të parashkrimit të shkaqeve të shkeljes së pretenduar.¹¹⁷

9.1. Komente të ILD-së

Koment faqe 43, për rubrikën “10.2. Komente të KSHH-së”, fjalja e parë, ku përcaktohet evitimi i praktikës së mbylljes së procedimeve disiplinore për çështjet e mbartura.

A mund të na jepen rastet që përbëjnë praktikë në vlerësimin e KShH? Nga të dhënat tona, nuk rezulton sasnë praktikë e mbyllur, pa iu nënshtuar një analize të ligjit, gjendjes dhe rrethanave të faktit për shkeljen e konstatuar dhe të argumentuar sipas ligjit, për secilin hetim të zhvilluar. Pavarësisht kësaj, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në njoftimin që i bën ankuesit për vendimin e arkivimit të ankesës, e informon edhe për të drejtën për t’u ankuar, si dhe ku mund të ankohet ndaj vendimit, bashkë me afatin brenda të cilit mund të ankohet. Do donim një evidentim konkret të rasteve.

9.2. Komente të KSHH

Lidhur me këtë koment të ILD-së, KSHH ripërsërit të njëjtin argument, të pasqyruar në paragrafin 5.2 të këtij raporti (pjesë e këtij aneksi).

¹¹⁷Vendim i KLGJ-së nr.717, datë 06.12.2023 për caktimin e relatorit dhe seancës dëgjimore për procedimin disiplinor të magistratit; Vendim i KLGJ-së nr. 702/2023, “Për shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

